

*Në bazë të seksionit 11.1 të Rregullores mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës nr. 2000/45 Kuvendi Komunal në Prizren, në mbledhjen e vet të mbajtur më datën 9 gusht 2001 miratoi këtë:*

# **S T A T U T**

## **Kapitulli I**

### **Dispozitat e përgjithshme**

#### **Pjesa I**

##### **Neni 1.**

Komuna është njësi territoriale-administrative në të cilën qytetarët realizojnë vetëqeverisjen në pajtim me dispozitat e Rregullores nr. 2000-45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës (në tekstin e mëtejme Rregullore) dhe me këtë Statut.

##### **Neni 2.**

Komuna e Prizrenit (në tekstin e mëtejme Komuna), ka emblemën, flamurin dhe simbolet e veta.

Emblema e Komunës është “Shtëpia e Lidhjes së Prizrenit”.

Përmbajtja dhe përdorimi i emblemës dhe i simboleve të tjera do të përcaktohet me vendim të posaçëm të Kuvendit.

Asnjë person, ose institucion tjetër, nuk guxon ta përdorë emblemën e saj, flamurin ose simbolet e tjera të Komunës, pa autorizim të shkruar të saj.

### **Neni 3.**

Komuna gëzon statusin e personit juridik.  
Komuna qeveris me pasurinë e saj në pajtim me dispozitat e Rregullores 2000-45.

### **Neni 4.**

Selia e Komunës është në Prizren, rruga “Sheshi i Lidhjes së Prizrenit”.

### **Neni 5.**

Territori dhe kufijtë e Komunës janë të përcaktuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2000-43 shtojcën 1 këtu, e cila për këto qëllime do t'i bashkangjitet Statutit.

### **Neni 6.**

Kuvendi Komunal në pajtim me Seksionin 2.5 të Rregullores, mund t'i rekomandojë Autoritetit Qendror ndryshimin e kufijve të vet.

### **Neni 7.**

Komunën e përbëjnë qyteti, fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të përcaktuara në Aneksin B të Rregullores së UNMIK-ut 2000-43 (Aneksi 1 këtu) dhe i cili për këto qëllime (është i aplikueshëm për Komunën) do t'i bashkangjitet Statutit.

Kuvendi i Komunës me Vendim të posaçëm rregullon numrin dhe organizimin e ofiqarive si degë të deleguara të administratës nëpër fshatra, në pajtim me nevojat dhe mundësitë e veta.

Kuvendi i Komunës me Vendim të veçantë do të rregullojë mënyrën e konstituimit, kompetencat, organizimin, financimin dhe mënyrën e caktimit të udhëheqësive të fshatrave, lagjeve, bashkësive lokale apo njësive të tjera organizative të pushtetit në to. Kriteret për emërimin e udhëheqësive të fshatrave, lagjeve, bashkësive lokale apo njësive të tjera organizative të pushtetit në to, janë rezultatet nga zgjedhjet për pushtetin lokal.

Në kuadrin e territorit të Komunës së Prizrenit janë qyteti i Prizrenit dhe këto fshatra: (në kllapa figurojnë emërtimet që janë në qarkullim)

Billushë	(Kushtrim)
Caparc	(Capar)
Dedaj	(Dedaj)
Dobrusht	(Mirëz)
Dojnicë	(Dojnicë)
Drajçiq	(Drajçiq)
Dushanovë	(Arbanë)
Gërçar	(Gërçar)
Gornjasellë	(Gornjasellë)
Gorozhup	(Gurishtë)
Grazhdanik	(Grazhdanik)
Gjonaj	(Gjonaj)
Hatmaxhë	(Shkabë)
Hoçë e Qytetit	(Hoçë)
Jabllanicë	(Jabllanicë)
Jeshkovë	(Gjeq)
Kabash	(Kabash)
Kabash i Hasit	(Kabash i Hasit)
Karashëngjergj	(Shëngjergj)
Kobaj	(Kobaj)
Kojushë	(Kajushë)
Korishë	(Korishë)
Krajk	(Krajk)
Krushë e Vogël	(Dardhëz)
Kushtendil	(Kushnin)
Kushnin	(Kushnin i Hasit)
Landovicë	(Landovicë)
Leskovec	(Arbëri)
Lez	(Lez)
Llokvicë	(Llokvicë)
Lubinja e Epërme	(Lubinja e Epërme)
Lubinja e Poshtme	(Lubinja e Poshtme)
Lybiqevë	(Malësia e Vrrinit)
Lubizhdë	(Lugishta e Qytetit)

Lubizhdë e Hasit	(Lugishtë)
Lukinaj	(Lukinaj)
Lutogllavë	(Legjendë)
Malësia e Re	(Pusi i Atit)
Mamushë	(Mamushë)
Manastiricë	(Manastiricë)
Mazrrek	(Mazrrek)
Medvec	(Ilirida)
Milaj	(Milaj)
Muradem	(Muradem)
Mushnikovë	(Mushnikovë)
Nashec	(Syzi)
Nëpërgoshti	(Nëbregosht)
Novakë	(Novakë)
Novosellë	(Novosellë)
Petrovasellë	(Therandë)
Piranë	(Piranë)
Planejë	(Planejë)
Pllanjan	(Pllanjan)
Poslisht	(Gurrë)
Pouskë	(Pouskë)
Randobravë	(Qëndresë)
Reçan	(Reçan)
Romajë	(Ramajë)
Sërbicë e Epërme	(Arbëneshë)
Sërbicë e Poshtme	(Arbanas)
Skarabisht	(Shkorret)
Smaç	(Ardianë)
Sreckë	(Sreckë)
Struzhë	(Sharr)
Shkozë	(Shkozë)
Shpinadi	(Shpenadi)
Trepetnicë	(Mirditë)
Tupec	(Tupec)
Velezhë	(Velezhë)
Vërmicë	(Drinas)
Vlashnjë	(Vlash)

Zojz	(Zogaj)
Zym	(Zym)
Zhivinjan	(Zhivinjan)
Zhur	(Zhur)

### **Neni 8.**

Kuvendi i Komunës, varësisht nga dispozitat e Rregullores dhe të Statutit, mund të delegojë autorizime në lidhje me kompetencat e shërbimeve komunale në fshatra, vendbanime, lagje.

Komiteti për Politikë dhe Financa, në bashkëpunim të ngushtë me përfaqësuesit e fshatrave, respektivisht B.L, zhvillon një sistem për pjesëmarrje të qytetarëve në shërbimet komunale.

Për çdo vit fiskal, të gjitha marrëveshjet për mbikëqyrje të përbashkët të aktiviteteve të tilla të ndërmarra, duhet të aprovohen nga Kuvendi Komunal në pajtim me Statutin dhe Rregullat e Procedurës.

Të gjitha këto aranzhmane duhet të jenë me shkrim dhe nuk mund të jenë me kohëzgjatje më tepër se mandati i Kuvendit Komunal. Aranzhmanet duhet të mbulojnë, në mes tjerash: 1. Fondin, 2. Të ardhurat, 3. Shërbimet dhe 4. Administratën.

Menaxhimi i përbashkët për aranzhmanet e ndërmarra, në pajtim me këto dispozita, mund të implementohet, në mes tjerash, me një Bord të përbashkët mbikëqyrës dhe Kuvendi Komunal mund të emërojë anëtarët e këtyre bordeve për t'i prezentuar dhe mbrojtur interesat e tij, duke shfrytëzuar mundësitë e realizimit sa më të mirë.

### **Neni 9.**

Komuna e ka vulën e rrumbullakët dhe vulën katrore të Protokollit (vulat e Komunës).

Vula e rrumbullakët ka tekstin, në mes të vulës është emblema, brenda saj është emri: Kuvendi Komunal Prizren.

Vula e Protokollit të Komunës ka formën e katërkëndëshit kënddrejtë me tekstin – Komuna e Prizrenit, nr. \_\_\_\_\_ dhe dt \_\_\_\_\_.

### **Neni 10.**

Vulat e Komunës dhe organeve të saj, janë të veçanta për këto gjuhë, - shqip, boshnjakisht, serbisht dhe turqisht. Në secilën vulë, krahas gjuhës përkatëse do të jetë edhe teksti në anglisht.

### **Neni 11.**

Mënyra e mbajtjes dhe përdorimit të vulave të Komunës përcaktohet me vendim të posaçëm të Bordit të Drejtorëve. Vulat përdoren vetëm për punë zyrtare të Komunës.

### **Neni 12.**

Komuna do të ketë si festë publike 10 Qershorin – Ditën e themelimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.  
Komuna e kremton Ditën e Çlirimit, 12 Qershorin.

### **Neni 13.**

Në pajtim me seksionin 3.2 (f) të Rregullores, Kuvendi i Komunës ndan shpërblime, dekorata dhe mirënjohje.  
Llojet e shpërblimeve, dekoratave dhe mirënjohjeve, kushtet dhe mënyrën e ndarjes së tyre i cakton me vendim të posaçëm Kuvendi i Komunës.

### **Neni 14.**

Në kufijtë dhe territorin e Komunës, pjesëtarëve të komuniteteve kombëtare dhe bashkësive nacionale u garantohet e drejta e deklaramit të lirë të identitetit etnik, kulturor dhe fetar. Pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë të komunikojnë në gjuhën e tyre me organet dhe shërbimet civile në Komunë, në pajtim me ligjet në fuqi dhe konventat ndërkombëtare.

### **Neni 15.**

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës, komiteteve të tij dhe tubimet e tjera zhvillohen në gjuhën e pjesëmarrësve të mbledhjes.

### **Neni 16.**

Të gjitha dokumentet zyrtare të lëshuara nga Komuna do të jenë në pajtim me dispozitat e Rregullores dhe posaçërisht me Seksionin 9.3.

Si plotësim, të gjitha dokumentet zyrtare të lëshuara nga Komuna do të jenë në gjuhën e palës, gjegjësisht shqip, boshnjakisht, serbisht dhe në gjuhën turke.

### **Neni 17.**

Në organet dhe shërbimet publike të qeverisjes lokale sigurohet përfaqësimi proporcional i pjesëtarëve të komuniteteve kombëtare dhe bashkësive nacionale dhe gjinore.

## **Pjesa II**

### **Neni 18.**

Ky Statut përcakton:

- 1.Përgjegjësitë dhe funksionet e Kuvendit të Komunës,
- 2.Pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve, aktivitetin dhe mënyrën rreth vendosjes së punëve në kuadër të kompetencave të Komunës,
- 3.Organet e Kuvendit të Komunës dhe Shërbimit Civil,
- 4.Të drejtat dhe detyrat e anëtarit të Kuvendit të Komunës,
- 5.Administrimin financiar,
- 6.Konfliktin e interesave dhe
- 7.Dispozitat e veçanta.

## **Kapitulli II**

### **Pjesa I**

## **Përgjegjësitë dhe kompetencat e Komunës**

### **Neni 19.**

Në pajtim me Seksionin 3. të Rregullores, Komuna është përgjegjëse për aktivitetet si këto:

1. Ofrimin e kushteve lokale themelore për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik,
2. Planifikimin urban dhe të fshatit, si dhe shfrytëzimin e tokës,
3. Lëshimin e lejeve për ndërtim dhe zhvillime të tjera,
4. Mbrojtjen lokale të ambientit,
5. Implementimin e rregullave ndërtimore dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimeve,
6. Ofrimin e shërbimeve lokale dhe infrastrukturës, duke përfshirë furnizimin me ujë, ujësjellësin dhe kanalizimin, përpunimin e ujërave të zeza, rrugët lokale, transportin lokal dhe planet për ngrohjet lokale,
7. Shërbimet publike duke përfshirë shërbimet e zjarrëfikësve dhe të emergjencës,
8. Udhëheqjen e pronës së Komunës,
9. Shkollimin paraprak, fillor dhe të mesëm,
10. Kujdesin primar shëndetësor,
11. Shërbimet sociale dhe strehimin,

12. Mbrojtjen e konsumatorëve dhe shëndetin publik,
13. Lëshimin e lejeve për shërbime dhe pajisje, duke përfshirë argëtimin, ushqimin, tregjet, shitjet në rrugë, transportin lokal publik dhe shërbimin e taksistëve, gjuetinë e peshkimin, restorantet dhe hotelet,
14. Panairet dhe tregjet,
15. Emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve dhe rrugicave vendeve të tjera publike në pajtim me dispozitat e Kapitullit 1, neni 9 dhe Kapitulli 2, neni 11/3-i të Rregullores.

16. Sigurimin dhe mirëmbajtjen e parqeve publike, hapësirave të hapura dhe varrezave.

17. Aktivitetet e tjera të ngjashme dhe të rëndësishme për administrimin adekuat të territorit komunal, që nuk janë të përcaktuar gjetiu me ligj.

Si plotësim i aktiviteteve të përmendura më sipër, Komuna mund të marrë veprime të tjera lidhur me çështjet me interes për Komunën, si:

1. Turizmi,
2. Aktivitetet kulturore,
3. Sportet dhe aktivitetet e tjera,
4. Aktivitetet e rinisë,
5. Avancimi i ekonomisë,
6. Avancimi i vlerave qytetare.

Komuna, gjithashtu është përgjegjëse për implementimin e Rregulloreve të Autoritetit Qendror, duke përfshirë regjistrat kadastralë, regjistrat civilë, regjistrin e votuesve dhe regjistrimin e bizneseve. Burimet përkatëse për këto qëllime vihen në dispozicion të Komunës nga Autoriteti Qendror.

Lista e përmendur më lart e përgjegjësive është një ekstrakt nga Rregullorja dhe përderisa Rregullorja nuk ndryshon, nuk duhet t'i nënshtrohen asnjë ndryshimi, plotësimi ose modifikimi të këtij Statuti, duke përfshirë këtu edhe nenet 39 dhe 97.

## **Kapitulli III**

### **Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e qytetarëve në mbledhje, aktiviteti dhe mënyra e vendosjes në punët publike.**

#### **Pjesa II**

##### **Neni 20.**

Në pajtim me Rregullat e procedurës, qytetarët në Komunë mund t'i: – 1. shqyrtojnë dhe propozojnë çështjet me interes publik përmes konsultimeve dhe - 2. përmes pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të tyre në tubime, varësisht nga dispozitat e nenit 45 këtu.

##### **Neni 21.**

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave të qytetarëve, Komuna mund të përdorë mekanizmat e realizimit, si:

1. Fushatën informative dhe ato të publicitetit për promovimin e programeve dhe aktiviteteve komunale,
2. Kontaktet me qarqe të zgjedhura për ta vënë në sprovë dhe për të diskutuar politikën,
3. Anketat sa i përket implementimit të politikës, ku do të përfshiheshin përveç tjerash, informues kyç, klientë dhe qytetarë të prekur nga kjo,
4. Shpalljet publike të propozimeve lidhur me politikën apo projektregullore, duke ftuar pjesëmarrjen me prezantime,
5. Kontaktet kyçe me grupe përkatëse të interesit,
6. Takimet publike

7. Seancat publike,
8. Hetimet publike,
9. Hulumtimi i OP
10. Komitetet këshilldhënëse,
11. Referendumet në pajtim me nenin 29-32

Në çdo rast do të jepet një arsyetim i bazuar për zgjedhjen e mekanizmave të konsultimit, apo pjesëmarrjes publike dhe do të lejohet një afat kohor i mjaftueshëm për paraqitjen e propozimeve.

Rezultatet do të merren parasysh dhe do të publikohen para se të merret vendimi përfundimtar.

### **Neni 22.**

Komuna dhe komitetet e saj, para miratimit të rregulloreve komunale, praktikojnë konsultë publike, duke i ofruar informata të nevojshme publikut për propozime. Shpallja publike e propozimeve dhe diskutimi për to zhvillohet së paku katërmbëdhjetë ditë.

### **Neni 23.**

Në pajtim me Seksionin 8.1 të Rregullores, Komuna së paku dy herë në vit duhet të organizojë tubime publike me qytetarët, si formë e realizimit të vetëqeverisjes lokale.

Në tubimet publike, përfaqësuesit komunalë informojnë pjesëmarrësit për çështjet që i përkasin interesit të përbashkët për zhvillimin e jetës dhe politikës komunale.

Tubimet janë të karakterit të hapur dhe në to mund të marrin pjesë të gjithë të interesuarit, varësisht nga dispozitat e këtij Statuti duke përfshirë nenin 25. këtu.

Pjesëmarrësit në këto tubime mund të marrin iniciativa, të japin propozime, sugjerime dhe të shprehin mendime për zgjidhjen e çështjeve të caktuara, varësisht nga dispozitat e këtij Statuti duke përfshirë nenin 25 këtu.

Njëra prej këtyre mbledhjeve do të mbahet gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit , ndërsa tjetra do të mbahet gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit fiskal.

Nëse vetëm dy mbledhje publike mbahen gjatë vitit fiskal, atëherë duhet të ketë një interval prej së paku dy muaj ndërmjet mbledhjeve. Tubimet e tilla mund të organizohen nëpër fshatra, lagje dhe vendbanime të caktuara.

#### **Neni 24.**

Koha, dita dhe vendi ku mbahet tubimi publik shpallet përmes Mjeteve të Informimit Publik dhe atë dy javë para mbajtjes së tubimit.

Shpalljen publike e bën Komuna.

Tubimet publike janë të hapura për përfaqësuesit e Mjeteve të Informimit Publik.

#### **Neni 25.**

Tubimet publike i udhëheq dhe i kryeson kryetari i Kuvendit.

Ai (ajo) ka autoritetin të caktojë rendin e ditës dhe procedurën për udhëheqje të diskutimeve. Në rast nevoje, ka të drejtë që të ndërpresë diskutimet për çështjet që nuk kanë të bëjnë me përgjegjësitë dhe pushtetin e Komunës. Ai-ajo mund të refuzojë të thërrasë ose të dëgjojë folësit të cilët prezentojnë ose përsërisin pikëpamjet dhe mund të imponojë kufizimin e përgjithshëm të kohës së lejuar për fjalime.

Nëse shtrohet ndonjë pyetje gjatë tubimit publik, pyetje për të cilën aty për aty nuk mund të jepet përgjigje, parashtruesi ka të drejtë të kërkojë përgjigjen me shkrim brenda 30 ditëve pas mbajtjes së tubimit.

#### **Neni 26.**

Për çdo tubim publik mbahet procesverbali i cili përmban të gjitha informatat e dhëna nga përfaqësuesit komunalë, propozimet e parashtruara nga publiku dhe reagimin ndaj tyre, si dhe të gjitha pyetjet dhe përgjigjet e dhëna.

Procesverbalin me të gjitha çështjet e diskutuara dhe propozimet e dhëna i shqyrton Komiteti për Politikë dhe Financa, në afat prej 60 ditëve nga dita e mbajtjes së tubimit. Komiteti analizon çdo propozim të parashtruar në tubim dhe bën rekomandimet e nevojshme të cilat ia propozon Kuvendit Komunal për tubimin e ardhshëm.

## **Neni 27.**

Në pajtim me dispozitat e Seksionit 8.2 të Rregullores, çdo qytetar dhe person juridik që ka interes në Komunë, ka të drejtë që me vetiniciativë, përmes formës së peticionit t'i propozojë Kuvendit të Komunës nxjerrjen e rregulloreve, zgjidhjen e çështjeve të rëndësishme për qytetin, fshatin, lagjen, vendbanimin, në pajtim me Rregulloren.

Subjektet e përmendura më lart mund t'i drejtojnë peticion Kuvendit të Komunës për çështjet që janë në kompetencën e tij në mënyrë të pakufizuar e që kanë të bëjnë me:

1. Rregullimin e qytetit,
2. Mirëmbajtjen e rendit dhe infrastrukturën e Komunës,
3. Urbanizimin e qytetit,
4. Mbrojtjen e mjedisit jetësor,
5. Implementimin e vetëkontrollit, organizimin e Referendumit dhe
6. Çështje të tjera të rëndësishme për jetën e popullatës vendore.

Një nismë e tillë e subjekteve fillon me nënshkrimin e tyre, në formë të peticionit, me propozim të veçantë të çështjes së caktuar dhe i drejtohet Kuvendit të Komunës përmes Kryeshefit Ekzekutiv.

Çdo peticion duhet të përmbajë emrin dhe adresën e parashtruesit, emrat dhe adresat e nënshkruesve, si dhe lëndën e peticionit.

Një peticion i cili nuk përmban elementet e duhura nuk do të konsiderohet i vlefshëm.

## **Neni 28.**

Kryeshefi Ekzekutiv, në afat prej 6 (gjashtë) javësh, nga dita që ai e pranon çdo peticion të vlefshëm ia prezenton Kuvendit të Komunës. Kuvendi i Komunës mund t'ia referojë për shqyrtim të mëtejme komitetit të caktuar.

Në mbledhje të komitetit, me rastin e shqyrtimit parashtruesi (et) i-e peticionit ka të drejtë të pjesëmarrjes direkte me rastin e shqyrtimit.

Vendimin përfundimtar për çështjen e peticionit e merr Kuvendi i Komunës në afatin prej gjashtë javësh nga dita e prezentimit të peticionit në Kuvend.

Vendimi do të arsyetohet me shkrim dhe do t'iu kumtohet parashtruesve të peticionit.

# **R e f e r e n d u m i**

## **Pjesa III**

### **Neni 29.**

Për disa çështje me interes të përgjithshëm që kanë të bëjnë me kompetencat e Komunës, për të cilat Kuvendi i Komunës për arsye të ndryshme nuk merr vendim përfundimtar, atëherë organizon referendum.

Referendumi në nivel të Komunës mund të organizohet me iniciativë të Kuvendit Komunal dhe me vetiniciativën e qytetarëve me të drejtë vote dhe të regjistruar.

Referendumi mund të organizohet dhe të shpallet për territorin e Komunës, ose për disa fshatra apo lagje.

Vendimin për shpalljen e referendumit e miraton Kuvendi i Komunës me shumicë votash të anëtarëve prezentë.

### **Neni 30.**

Çdo propozim për organizimin dhe zhvillimin e referendumit përcillet me një arsyetim të bazuar, së bashku me:

- pyetjen e parashtruar për vendimin që kërkohet përgjigja e cila mund të jetë po ose jo,

- vlerësimin mbi shpenzimet dhe burimet e mjeteve,

- nënshkrimet, emrat e plotë dhe adresat e parashtruesve që bëjnë kërkesën për organizimin e Referendumit kur Kuvendi i Komunës nuk vepron me vetiniciativë,

- Kuvendi i Komunës cakton datën se kur do të mbahet Referendumi dhe zhvillimin e referendumit e mbikëqyr një komision profesional i pavarur.

### **Neni 31.**

Referendumi mund të përsëritet në afat prej më së paku 6 (gjashtë) muajsh nga zhvillimi i Referendumit paraprak.

Referendumi nuk mund të zhvillohet gjatë periudhës kohore prej 6 muajsh para skadimit të mandatit të anëtarëve të Kuvendit, apo pasi të shpallet data për mbajtjen e zgjedhjeve komunale.

### **Neni 32.**

Rezultatet e Referendunit publikohen në afat prej 15 ditëve nga dita e mbajtjes së tij.

Referendumi do të konsiderohet i suksesshëm në qoftë se për propozim votojnë më tepër se gjysma e numrit të përgjithshëm të qytetarëve që votojnë në mjedisin ku organizohet Referendumi.

## **Kapitulli IV**

### **Organet e Kuvendit Komunal dhe Shërbimit Civil**

#### **Pjesa I**

### **Neni 33.**

Komuna ka organet e veta, të cilat kryejnë funksionet e përcaktuara me Rregullore dhe me Statut.

Varësisht nga dispozitat e Rregullores dhe Statutit, Kuvendi i Komunës, në pajtim me ligj mund të bëjë marrëveshje në bashkëpunim me kuvendet e tjera komunale.

### **Neni 34.**

Komuna sipas nevojës dhe në pajtim me nenin 40.2 të Rregullores, mund të bëjë aranzhmane ndërmjet komunave për mbikëqyrjen e përbashkët të ndërmarrjeve komunale që ofrojnë shërbime komunale për më shumë se një Komunë.

Të gjitha marrëveshjet për mbikëqyrje të përbashkët të aktiviteteve të ndërmarrjeve të tilla duhet të aprovohen nga kuvendet e komunave në pajtim me Statutin dhe Rregullat e Procedurës.

### **Neni 35.**

Aranzhmanet e ndërmarra në pajtim me nenin 8 dhe 34 këtu, duhet të jenë në pajtim me dispozitat e përcaktuara me këtë artikull.

Komiteti për Politikë dhe Financa ia paraqet Kuvendit të Komunës rekomandimet përkitazi me aranzhmanet që mund të nevojiten konform nenit 3.6 të Rregullores dhe të cilat përfshijnë aranzhmanet ndërmjet Komunave për kryerjen e përgjegjësisë dhe të kompetencave në bashkëpunim me njëra-tjetrën.

Komiteti për Politikë dhe Financa ia paraqet Kuvendit të Komunës rekomandimet lidhur me menaxhimin e ndërmarrjeve komunale si dhe përkitazi me aranzhmanet që mund të nevojiten konform me nenin 40.2 të Rregullores dhe të cilat përfshijnë aranzhmanet ndërmjet komunave për mbikëqyrjen e përbashkët të ndërmarrjeve komunale që ofrojnë shërbime komunale lokale për më shumë se një Komunë.

### **Neni 36.**

Organet e Komunës janë – Kuvendi i Komunës, Kryetari i Kuvendit të Komunës, Zëvendëskryetarët, Komitetet, Kryeshefi Ekzekutiv, Bordi i Drejtorëve, Drejtoritë Komunale dhe cilido person ose organizatë që vepron me autorizimin e Organeve të Komunës.

Komuna ka bashkëpunim dhe bashkëkoordinim të punëve dhe detyrave që i delegohen nga Autoriteti Qendror (Departamenti i Administratës Lokale dhe KPAK – Këshilli i Përkohshëm Administrativ i Kosovës) dhe nuk mund ta cenojë karakterin unik të tij.

Kuvendi i Komunës me Vendim të posaçëm mund të caktojë edhe organe të tjera sipas nevojës.

### **Neni 37.**

Komuna ka edhe Avokaturën Publike, e cila punon në pajtim me Ligjin e aplikueshëm mbi Avokaturën Publike.

Emërimin e Avokatit Publik dhe zëvendësavokatit publik e bën Kuvendi i Komunës në pajtim me Ligjin aplikativ mbi Avokaturën Publike.

## **Kuvendi Komunal**

### **Seksioni 1.**

#### **Neni 38.**

Siç është paraparë në Seksionin 10.1 të Rregullores, Kuvendi i Komunës është organi më i lartë përfaqësues i Komunës, i cili ushtron funksionin e pushtetit lokal të përcaktuar me Rregullore dhe me Statut.

Nëse nuk parashihet ndryshe në Rregullore dhe në Statut, përgjegjësitë dhe funksionet e Komunës duhet të ushtrohen nga Kuvendi i Komunës dhe Organet e Komunës.

Pushteti dhe përgjegjësitë e Kuvendit të Komunës janë pa kufizime, varësisht nga Seksionet 47 dhe 48 të Rregullores.

Kuvendi zgjedhet në mënyrë direkte në pajtim me dispozitat e Rregullores dhe veçanërisht duke u bazuar në Seksionin 10.3. Mandati i anëtarëve të Kuvendit është 4 (katër) vjeçar. Mandati i parë i anëtarëve të Kuvendit është 2 (dy) vjet.

Anëtarët e Kuvendit kanë të drejta të njëjta dhe të barabarta, të përcaktuara me këtë Statut dhe Rregullat e Procedurës së Kuvendit.

# **Kompetencat e uendit të Komunës**

## **Seksioni 2.**

### **Neni 39.**

Siç është paraparë në Seksionin 11. të Rregullores, Kuvendi i Komunës miraton Statutin. Kuvendi i Komunës mund ta ndryshojë Statutin nëse konsideron se një ndryshim i tillë është i nevojshëm.

Statuti duhet të rregullojë realizimin e përgjegjësive të Komunës ashtu siç është përcaktuar me këtë Statut.

Statuti, për t'u aprovuar në pajtim me dispozitat e mëparshme, duhet të jetë konform me Udhëzimin Administrativ të UNMIK-ut numër 2000-28 dhe që është dhënë në Shtojcën 2 këtu.

Në pajtim me Seksionin 11. të Rregullores, çdo vendim për miratim apo ndryshimin e Statutit duhet të aprovohet me më shumë se dy të tretat e anëtarëve prezentë që votojnë në mbledhjen në të cilën shqyrtohet propozimi.

Kuvendi i Komunës i miraton Rregullat e Procedurave dhe mund t'i ndryshojë ato nëse konsideron se një gjë e tillë është e nevojshme. Rregullat e Procedurës duhet të sigurojnë udhëheqjen dhe kontrollin, duke përfshirë kontrollin efikas financiar të Administratës së Komunës.

Siç parashihet në Seksionin 11.2 të Rregullores, vendimi për miratimin apo ndryshimin e Rregullave të Procedurave aprovohet nga më shumë se gjysma e anëtarëve prezentë që votojnë në mbledhjen në të cilën shqyrtohet propozimi.

Kuvendi i Komunës, nga kompetencat e veta, miraton Vendime dhe akte të tjera juridike.

## **Neni 40.**

Procedura për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës do të jetë si vijon:

Çdo anëtar i Kuvendit mund të bëjë propozim për ndryshime në Statut (propozimet për ndryshim) në pajtim me dispozitat e Statutit dhe Rregullat e Procedurës. Propozimet e tilla do të jenë me shkrim të drejtuara Kryetarit. Propozimet për ndryshim duhet të përmbajnë qartë hollësitë e ndryshimeve që janë propozuar. Kryetari duhet t'i dërgojë propozimet për ndryshim në Komitetin për Politikë dhe Financa për shqyrtim.

Pavarësisht nga ajo që u tha, procedurat në vijim duhet të përcillen:

Propozimi për ndryshim duhet të aprovohet nga ana e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Propozimi për ndryshim më pas do t'i dërgohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim paraprak. Nëse Kuvendi nuk e refuzon propozimin, ai do të ndër marrë masa të konsultimit publik në lidhje me propozimin, siç parashihet në nenin 21 të këtij Statuti.

Pas përfundimit të konsultimit publik, Kuvendi i Komunës do të vendosë (me votim) se a do t'i miratojë ndryshimet, pasi t'i vlerësojë të gjitha propozimet që ka pranuar.

Rregullat e procedurës mund të rregullojnë më tej procedurat për plotësimin e Statutit.

## **Neni 41.**

Siç është paraparë në Seksionin 11.3 të Rregullores, Kuvendi i Komunës nuk mund të delegojë kompetencën e vet për marrjen e vendimeve lidhur me:

1. aprovimin e buxhetit,
2. aprovimin e çështjeve të tjera financiare, që sipas Statutit dhe Rregullave të Procedurave i janë lënë Kuvendit,
3. kompensimet për anëtarët e zgjedhur,
4. raportin vjetor,
5. miratimin, ndryshimin dhe anulimin e Rregulloreve dhe akteve të tjera komunale,
6. krijimin e Komiteteve që përcakton Statuti,
7. emërimin e Drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të Komunës,
8. emërimin e Zyrtarit të Lartë Ekzekutiv,

9. emërimin e Bordit të Drejtorëve,
10. nivelin e pagesës së taksave dhe shpenzimeve komunale,
11. miratimin e vendimit për përdorimin e simboleve, dekorimeve dhe titujve të nderit në pajtim me Rregulloren e Pushtetit Qendror,
12. bërjen e planeve dhe marrëveshjeve në mes të komunave,
13. Kuvendi i Komunës mund të delegojë autorizimin lidhur me nxjerrjen e ndonjë Vendimi tjetër një Komiteti të Kuvendit, Kryetarit, Kryeshefit Ekzekutiv apo Bordit të Drejtorëve. Kuvendi i Komunës autorizimin e deleguar mund ta revokojë në çdo kohë. Një autorizim i deleguar mund të delegohet edhe më tej brenda autoritetit të caktuar me këtë Statut,
14. Vendimi për emërtimin apo riemërtimin e çfarëdo sheshi, rruge apo vendi tjetër publik duhet të miratohet nga më së paku dy të tretat e anëtarëve të Kuvendit Komunal.

Lista e përmendur më lart e përgjegjësive të padelegueshme është një ekstrakt nga Rregullorja dhe përderisa Rregullorja nuk ndryshon, nuk mund t'i nënshtrohet asnjë ndryshimi, plotësimi ose modifikimi.

Si shtesë në listën e përgjegjësive të padelegueshme të marra nga Rregullorja, e cila paraqitet më lart, çështjet në vijim mbeten në kompetencë të Kuvendit të Komunës dhe nuk mund të delegohen:

1. Vendimet që kanë të bëjnë me qiranë dhe-ose shitjen e pronës së Komunës. Të gjitha Vendimet e Kuvendit të Komunës për dhënien me qira ose shitjen e pronës, ose ndërtimin varen nga Seksioni 44.2 i Rregullores.
2. Aprovimi i (1) planit të përgjithshëm urban, (2) planit të detajuar urban për hapësira, dhe (3) ndryshimi i tyre.

Kuvendi i Komunës mund të delegojë përgjegjësitë: e Komiteteve - ose Drejtorive të Komunës për rregullimin e ndërtesave.

3. Themelimi i ndërmarrjeve publike të Komunës.

# Mbledhja e parë dhe Betimi ose Deklarata Solemne

## Seksioni 3

### Neni 42.

Në pajtim me Seksionin 12 të Rregullores, Kuvendi i Komunës mban mbledhjen e parë inauguruese brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga data e vërtetimit të rezultateve të zgjedhjeve. Përfaqësuesi më i vjetër i Kuvendit e kryeson çdo mbledhje derisa Kryetari ta ketë dhënë betimin ose Deklaratën Solemne.

Anëtarët e Kuvendit të Komunës nënshkruajnë betimin ose Deklaratën Solemne. Forma e betimit ose Deklaratës Solemne është si vijon:

*(Beto hem (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Prizrenit me nder, me besnikëri, pa anim dhe me ndërgjegje sipas ligjit, në mënyrë që të sigurohen kushtet për jetë të qetë për të gjithë).*

## Kryesimi i mbledhjeve

## Seksioni 4

### Neni 43.

Në pajtim me Seksionin 13. të Rregullores, Kuvendi i Komunës zgjedh Kryetarin e Komunës, i cili thërrret dhe i kryeson mbledhjet e Kuvendit të Komunës. Rregullat e Procedurës rregullojnë mënyrën e thirrjes dhe udhëheqjen e Kuvendit.

Rregullat e Procedurës rregullojnë gjithashtu çështjen e thirrjes dhe udhëheqjes së mbledhjeve nëse vendet e Kryetarit dhe të Zëvendëskryetarit janë të lira, ose nëse të dy për çfarëdo arsye, nuk janë në gjendje të marrin pjesë në mbledhje.

# **Kuorumi dhe mbledhjet**

## **Seksioni 5.**

### **Neni 44.**

Në pajtim me Seksionin 14 të Rregullores, kuorumi për të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të komiteteve të tij përbëhen prej më tepër se gjysmës së delegatëve të Kuvendit. Në të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të komiteteve, të gjithë anëtarët, duke përfshirë edhe kryesuesin e mbledhjes, kanë vetëm një votë, por kryesuesi e ka një votë shtesë në rast të numrit të njëjtë të votave për ose kundër ndonjë propozimi. Kuvendi i Komunës dhe Komitetet, marrin vendime me votim të hapur, përveç nëse kërkohet ndryshe me këtë Statut. Vendimet e Kuvendit të Komunës dhe të komiteteve të tij merren me votimin e shumicës së anëtarëve prezentë, përveç nëse kërkohet ndryshe me këtë Statut.

### **Neni 45.**

Kuvendi i Komunës duhet të mbledhet sa herë që është e paraparë me Rregullat e Procedurës, por duhet, së paku të mbajë (12) dymbëdhjetë mbledhje brenda vitit fiskal. Çdo mbledhje e tillë duhet të mbahet një herë në muaj.

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës, gjithashtu mund të thirren me kërkesën e një të katërtës të të gjithë delegatëve të zgjedhur ose me kërkesën e një Komiteti të Kuvendit. Mbledhjet e kërkuara nga anëtarët e Kuvendit duhet të caktohen në pajtim me Rregullat e Procedurës. Kuvendi i Komunës (Organet e Komunës p.sh. Kryetari) mund të thërrasë në çdo kohë brenda vitit fiskal, mbledhje të jashtëzakonshme për të diskutuar çështjet urgjente. Mbledhjet e tilla të jashtëzakonshme, duhet të thirren në pajtim me Rregullat e Procedurës.

Më së paku shtatë ditë pune para çfarëdo mbledhjeje të Kuvendit të Komunës, ose në raste urgjente, duke përfshirë mbledhjet e jashtëzakonshme tri ditë më herët, anëtarët e Kuvendit duhet të njoftohen për kohën, datën dhe vendin e mbledhjes, si dhe me rendin e ditës.

Njoftimet publike duhet, po ashtu, të shpallen në të njëjtën kohë. Nëse mbledhja është me dyer të mbyllura në pajtim me dispozitat e Rregullores dhe me Statut, njoftimi publik duhet të tregojë se mbledhja është e mbyllur për publik.

#### **Neni 46.**

Mënyra e punës dhe marrja e vendimeve nga ana e Kuvendit të Komunës duhet të përcaktohet me Rregullat e Procedurës.

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe mbledhjet e komiteteve siç është paraparë në Seksionin 7 të Rregullores, janë të hapura për publik. Pavarësisht nga ajo që u tha, Kuvendi i Komunës mund të mbajë mbledhje me dyer të mbullura në rrethanat e parapara në Seksionin 7 të Rregullores.

Kur Kuvendi ose komitetet e tij mbajnë mbledhje me dyer të mbyllura, duhet të paraqiten shënime të hapura për publik, të cilat tregojnë se është mbajtur mbledhja me dyer të mbyllura, datën dhe deklaratën që tregon se mbledhja është mbajtur në pajtim me dispozitat nga Seksioni 7, 3 dhe – ose 7,4 të Rregullores.

## **K r y e t a r i**

### **Seksioni 6**

#### **Neni 47.**

Kryetari i Komunës zgjedhet nga Kuvendi i Komunës, nga përbërja e anëtarëve të tij, në pajtim me dispozitat e Seksionit 24. të Rregullores. Kuvendi i Komunës do ta zgjedhë Kryetarin në mbledhjen e parë të mbajtur pas zgjedhjeve komunale. Nëse Kuvendi i Komunës nuk mund ta bëjë një gjë të tillë, kryesuesi do ta shtyejë mbledhjen dhe do ta mbajë mbledhjen për këtë qëllim në ndonjë ditë më vonë. Të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës do t'i kryesojë anëtari më i vjetër i Kuvendit deri sa të caktohet Kryetari.

Për të qenë të vlefshme kandidaturat për postin e Kryetarit, delegatët e Kuvendit të Komunës duhet t'i propozojnë dhe përkrahin kandidaturat. Kandidaturat mund t'i dorëzohen Kryeshefit Ekzekutiv me shkrim pas shpalljes së rendit të ditës për mbledhjen ku do të mbahen zgjedhjet, apo të prezentohen gojarisht në mbledhje.

#### **Neni 48.**

Kryetari i Kuvendit thërret mbledhjet e Kuvendit dhe i kryeson ato. Ai është përgjegjës për organizimin e punës së Kuvendit. Kryetari i Kuvendit është gjithashtu përgjegjës për koordinimin e punës së komiteteve të Kuvendit.

#### **Neni 49.**

Kryetari i Kuvendit ka edhe përgjegjësitë në vazhdim si shtesë e atyre që u janë caktuar nga Seksioni 28. l. i Rregullores:

1. propozon buxhetin dhe raportin vjetor të shpenzimeve, programet zhvillimore, planet urbanistike, planet dhe programet e tjera,
  2. propozon vendimet dhe aktet e përgjithshme, të cilat i miraton Kuvendi,
  3. kujdeset për zbatimin e dispozitave të Rregullores për Vetëqeverisje Komonale dhe dispozitave të tjera ligjore të Pushtetit Qendror,
  4. propozon Kryeshefin Ekzekutiv dhe anëtarët e Bordit të Drejtorëve,
  5. mbikëqyr Administrimin e Përgjithshëm Financiar të Komunës dhe zbatimin e vendimeve të miratuara nga Kuvendi i Komunës
  6. përcakton organizimin dhe mënyrën e punës së Administratës Komonale.
  7. jep pëlqimin në aktet mbi organizimin e brendshëm të Komunës,
  8. kujdeset për realizimin e publicitetit të punës së Kuvendit me anëtarët e Pushtetit Qendror dhe komunat e tjera,
  9. kujdeset për zbatimin e Rregullave të Procedurave dhe të Statutit.
- Kuvendi i Komunës mund të caktojë edhe përgjegjësi të tjera për Kryetarin, në pajtim me këtë Statut.

# **Zëvendëskryetari**

## **Seksioni 7**

### **Neni 50.**

Kuvendi i Komunës zgjedh Zëvendëskryetarin nga përbërja e delegatëve të tij, në pajtim me Seksionin 25 të Rregullores, me qëllim që t'i ndihmojë Kryetarit në kryerjen e funksioneve të tija.

Zëvendëskryetari duhet të zgjedhet sa më shpejt që është e mundur pas zgjedhjes së Kryetarit.

Zëvendëskryetari i përgjigjet Kryetarit, përpos nëse ai-ajo është duke vepruar në mugesë të Kryetarit dhe në atë rast ai-ajo i përgjigjet Kuvendit të Komunës.

Për të qenë emërimet e vlefshme për postin e Zëvendëskryetarit, anëtarët e Kuvendit të Komunës duhet t'i propozojnë dhe përkrahin emërimet.

Emërimet mund t'i dorëzohen Kryeshëfit Ekzekutiv me shkrim pas shpalljes së rendit të ditës për mbledhjen ku do të mbahen zgjedhjet, apo të prononcohen gojarisht në mbledhje.

Zëvendëskryetari do të ketë përgjegjësitë që i caktohen atij-asaj nga Seksionet 25. 1. 25.2 dhe 25.4 të Rregullores dhe ndonjë përgjegjësi tjetër të caktuar nga Kuvendi i Komunës ose Kryetari.

Kuvendi i Komunës mund t'i caktojë Zëvendëskryetarit detyra të tjera, në pajtim në këtë Statut.

### **Neni 51.**

Në pajtim me Seksionin 25.3 të Rregullores, një Zëvendëskryetar plotësues duhet të emërohet nga Kuvendi Komunal.

Për kandidimin e Zëvendëskryetarit plotësues duhet të ftohen përfaqësuesit e komuniteteve sipas seksionit 25,3 të Rregullores.

Emërimet duhet të bëhen nga Kuvendi i Komunës nga këto kandidatura.

Vendimi duhet të merret me votimin e shumicës së anëtarëve prezentë.

Zëvendëskryetari plotësues do të jetë përgjegjës për detyrat që i caktohen atij-asaj nga Kryetari.

Kuvendi i Komunës në çdo kohë mund t'i caktojë përgjegjësi të mëtejme Zëvendëskryetarit plotësues.

## **Kryeshefi Ekzekutiv**

### **Seksioni 8.**

#### **Neni 52.**

Në pajtim me Seksionin 30 të Rregullores, Kuvendi i Komunës me propozimin e Kryetarit të Komunës e emëron Kryeshefin Ekzekutiv.

Kryeshefi Ekzekutiv nuk është anëtar i Kuvendit. Kryeshefi Ekzekutiv është përgjegjës për detyrat dhe përgjegjësitë e tij-saj përmes Kryetarit dhe Komisionit për Politikë dhe Financa para Kuvendit të Komunës.

Kryeshefi Ekzekutiv, si shef i personelit dhe udhëheqës i Shërbimit Civil Komunal që vepron sipas autoritetit të gjithmbarshëm të Kuvendit të Komunës dhe kryetarit, do të bartë të gjitha përgjegjësitë që i caktohen atij-asaj me anë të Rregullores. Ai-ajo mund t'i delegojë përgjegjësitë anëtarëve të Bordit të Drejtorëve dhe anëtarëve të tjerë të shërbimit civil të Komunës, në pajtim me planin e kalimit të kompetencave të miratuar nga Komisioni për Politikë dhe Financa.

#### **Neni 53.**

Kryeshefi Ekzekutiv kryen këto punë:

1. kryen detyrën e sekretarit të Komunës,
2. kryeson Bordin e Drejtorëve,
3. kujdeset për ligjshmërinë e punës së Organeve të Administratës.
4. kujdeset për ligjshmërinë e punëve financiare të Komunës, zbatimin e procedurave dhe të kontrollit të efektiveve financiare, në përputhje me kërkesat e Pushtetit Qendror,

5. është përgjegjës për zbatimin e dispozitave që dalin nga Rregulloret, Statuti, Rregullat e Procedurave para Kuvendit, Kryetarit, Komiteteve dhe Bordit të Drejtorëve,
6. udhëheq me personelin e Shërbimit Civil të Komunës dhe është përgjegjës për kushtet e emërimit dhe shkarkimit – largimit të personelit në Shërbimin Civil të Komunës,
- 7.përgatit propozimin e vendimeve dhe akteve të tjera që i propozohen Kuvendit për miratim,
8. kujdeset për organizimin dhe mirëmbajtjen e seancave të Kuvendit, të Komiteteve, të Bordit të Drejtorëve dhe organeve të tjera,
9. kryen edhe punët e tjera që i caktohen me Rregullore, Statut, dhe-ose Rregullat e procedurave që i ngarkohen nga Kryetari dhe Kuvendi i Komunës.
10. Kryeshefi Ekzekutiv lëshon urdhëresa administrative,
11. me ndihmën e Bordit të Drejtorëve, Kryeshefi Ekzekutiv siguron që të gjitha organet e Komunës, institucionet dhe ndërmarrjet të udhëhiqen dhe koordinohen në mënyrë efikase në të gjitha nivelet,
12. Kryeshefi Ekzekutiv do të përcjellë implementimin rregulloreve të Komunës. Ai-ajo do të përgatisë propozime për aprovimin ose ndryshimin e rregulloreve lokale komunale sipas nevojës,
13. përmes Bordit të Drejtorëve, Kryeshefi Ekzekutiv do të sigurojë ekzekutimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës, komisioneve të tij dhe drejtorëve,
14. Kryeshefi Ekzekutiv do të sigurojë që Shërbimi Civil Komunal të sigurojë qasje të drejtë dhe të barabartë për ato shërbime publike që janë nën përgjegjësinë e Komunës,
15. Kryeshefi Ekzekutiv do të sigurojë që të ofrohen mundësi të barabarta punësimi në Shërbimin Civil Komunal në të gjitha nivelet.

**Kryeshefi Ekzekutiv:**

- a) propozon ndryshime të Statutit ose të Rregullave të Procedurës për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Komunës,
- b) propozon Kuvendit të Komunës ndryshime në funksionimin, numrin e drejtorëve dhe drejtorive, numrin dhe kushtet e punësimit të anëtarëve të Shërbimit Civil Komunal,

- c) jep propozime Kuvendit të Komunës për konstituimin, organizimin dhe bashkërenditjen e organeve komunale, si dhe krijimin e institucioneve dhe ndërmarrjeve,
- d) bën ndarjen e përgjegjësisë në mes të drejtorive në kuadër të Shërbimit Civil Komunal, ku këto çështje nuk janë të rregulluara me Statut ose me Rregullat e Procedurës,
- e) bën ndarje ose kombinime të përkohshme të punës dhe përgjegjësisë në mes të drejtorive sipas nevojës.

#### **Neni 54.**

Për të pasur të drejtë për emërim, kandidati që konkurren për pozitë të Kryeshefit Ekzekutiv duhet:

- a) të jetë i aftë për të bartur përgjegjësitë e pozitës me orar të plotë pa kufizime ose pengesa ligjore,
- b) të ketë kualifikim përkatës akademik ose profesional (e preferueshme),
- c) të ketë përvojë të gjatë në Administratën Publike ose udhëheqjen e biznesit, preferohet në lëmin juridik ose financat,
- ç) të ketë aftësi për të drejtuar dhe udhëhequr organizatat e mëdha,
- d) të ketë shkathtësi dhe aftësi personale për të punuar në mënyrë të suksesshme në një shoqëri multietnike.

Ky Seksion do të zbatohet në varësi të kërkesave thelbësore ose atyre që bëhen sipas dispozitave speciale të Kapitullit 9 të kësaj Rregulloreje.

Kuvendi Komunal do të bëjë emërimet formale pas shqyrtimit të propozimit të arsyeshëm dhe të justifikuar nga Kryetari. Emërimi mund të bëhet për kohë të pacaktuar apo për kohë të caktuar dhe nuk është i lidhur me kushtet e punës të anëtarëve të Kuvendit të Komunës. Asnjë person, cili nuk ka kualifikimet e parapara me Statut, ose nuk ka qenë i paraparë në procesin e rekrutimit me anë të Statutit, nuk do të ketë të drejtë emërimi. Kryetari mund të caktojë më tepër se një kandidat, për t'u zgjedhur nga Kuvendi i Komunës.

Kryetari me ndihmën e Kolegjit do të udhëheqë procesin e zgjedhjes. Kolegji do të emërohet nga Kuvendi i Komunës dhe do të kryesohet nga Kryetari.

Kolegji në mesin e anëtarëve të vet emëron persona, të cilët nuk janë anëtarë të Kuvendit të Komunës bazuar në profesionalizimin, kualifikimet e tyre

akademike ose eksperiencës që kanë në Administratën Publike, udhëheqjen e biznesit, financat apo në lëmin juridik.

Para emërimit, Kryetari dhe Kolegji do ta informojnë Kuvendin e Komunës se kandidatët e paraqitur i përmbushin kushtet e parapara me Statut.

Rekrutimi do të bëhet me konkurs të hapur. Do të shpallet vendi i punës në konkurs dhe paraqitësit do të kenë së paku katërbëdhjetë ditë për të konkurruar duke filluar nga dita e shpalljes së konkursit.

Çdo kandidat duhet t'i dorëzojë dokumentet vijuese:

- 1) Fletaplikacionin e plotësuar,
- 2) Konfirmimin e shkruar nga paraqitësi për plotësimin e kushteve të nenit 54 (a),
- 3) Detajet e kualifikimit arsimor dhe profesional (dëshmi që tregojnë kualifikimin e kërkuar nga kandidati i suksesshëm),
- 4) Deklarata ndihmëse e paraqitësit ku jepen informatat për qëllimet e nenit 54 (c) – (e) dhe çfarëdo informacioni tjetër përkatës.

Kolegji mund të përgatisë teste praktike për kandidatët dhe të përdorë procedurën e listës së ngushtë. Kriteret e listës përfundimtare do të zbatohen vetëm për kualifikimet për emërimet dhe do të zbatohen në mënyrë të njëjtë për të gjithë kandidatët.

Të gjithë kandidatët, ose të gjithë paraqitësit në kuadër të listës së ngushtë, varësisht nga rasti, do të intervistohen i cili kryesohet nga Kryetari. Pastaj, Kolegji do të përgatisë vlerësim të shkruar për kandidatin e intervistuar, i cili do të jetë i drejtë dhe i barabartë për të gjithë të intervistuarit dhe do të udhëhiqet duke konsideruar vetëm përgatitjen profesionale. Vlerësimi do t'i prezentohet Kuvendit të Komunës para marrjes së vendimit.

## **Neni 55.**

Kryeshefi Ekzekutiv mund të shkarkohet në pajtim me Nenin 30.8 të Rregullores, vetëm nga Kuvendi i Komunës nëse konstatohet dështimi në punën e tij, ose në rast të mos përmbushjes së përgjegjësi në mënyrë adekuate. Përveç në rastet e shkeljeve të rënda, që arsyeton shkarkimin e menjëhershëm, Kuvendi i Komunës nuk do të shqyrtojë propozimin për të shkarkuar Kryeshefin Ekzekutiv, nëse nuk është përcjellë procedura e parashtruar në këtë nen.

Kuvendi i Komunës do ta informojë Kryeshefin Ekzekutiv me shkrim nëse konsideron se përmbushja e detyrave dhe sjellja e tij kanë rënë nën

standardin e pranueshëm. Në njoftim do të shënohen arsyet pse Kuvendi i Komunës mendon ashtu dhe veprimet që duhet t'i ndërmarrë Kryeshefi Ekzekutiv për të përmirësuar punën dhe sjelljen e tij ose saj. Kuvendi i Komunës mund t'i japë vërejtje se vazhdimi i punës ose sjelljes së pakënaqshme mund të rezultojë me shkarkim.

Kryeshefi Ekzekutiv mund të kërkojë çfarëdo veprimi në pajtim me dispozitat e procedurës disiplinore që të shqyrtohet nga një Kolegj i pavarur i emëruar nga Kuvendi i Komunës. Kolegji do të ketë së paku tre anëtarë. Të gjithë anëtarët e Kolegjit do të kenë përvojë përkatëse në Administratën Publike ose në procedurat e punësimit. Anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe të Shërbimit Civil Komunal në Komunë nuk do të kenë të drejtë të emërohen anëtarë të Kolegjit. Kryeshefit Ekzekutiv do t'i jepet mundësi e drejtë për t'iu drejtuar Kolegjit.

Pas shqyrtimit Kolegji do t'i japë rekomandime të shkruara Kuvendit të Komunës. Kuvendi i Komunës do t'i implementojë këto rekomandime, pos nëse ka arsye të justifikueshme, të cilat duhet shënuar në procesverbal për të vepruar ndryshe.

Para se të merret çfarëdo vendimi sipas këtij neni, Kryeshefit Ekzekutiv do t'i mundësohet që t'i drejtohet Kuvendit të Komunës.

## **Shkarkimi nga detyra dhe vendi i punës**

### **Seksioni 9**

#### **Neni 56.**

Në pajtim me Seksionin 27 të Rregullores, Kryetari dhe Zëvendëskryetari mund të shkarkohen nga detyra vetëm me votat e më tepër se dy të tretave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit të Komunës, vetëm në rast se nuk janë përmbushur autorizimet dhe obligimet sipas këtij Statuti (45,27.1). Në pajtim me Seksionin 31.4 të Rregullores, drejtorin mund ta shkarkojë vetëm Kuvendi i Komunës, për arsye të moskryerjes si duhet të obligimeve të tij ose të saj dhe kur nuk ka nevojë më për atë post.

Dispozitat e këtij Statuti dhe Rregullat e Procedurës rregullojnë procedurën e shkarkimit të cilitdo nga nëpunësit e përmendur këtu.

## **K o m i t e t e t**

### **Pjesa 2**

#### **Neni 57.**

Në pajtim me Seksionin 21.1 të Rregullores, Kuvendi i Komunës formon tri Komitete të Obligueshme siç janë:

1. Komiteti për Politikë dhe Financa,
2. Komiteti për Komunitete dhe
3. Komiteti për Ndërmjetësim

(tash e tutje të përmendura si Komitete të Obligueshme)

Përveç komiteve të obligueshme, Kuvendi, sipas nevojës, mund të formojë edhe komitete të tjera varësisht nga nevoja (Komitete jo të obligueshme).

Në emërimin e komiteve, duke përfshirë Komitetet e Obligueshme, Kuvendi i Komunës duhet të mundohet të sigurojë një barazi të drejtë gjinore për të gjitha komitetet.

Në pajtim me Seksionin 49 të Rregullores, Administratori i Komunës mund të emërojë anëtarë të Komitetit të Komuniteteve dhe Komitetit për Ndërmjetësim pa qenë anëtarë të Kuvendit të Komunës.

Në pajtim me Seksionin 21.4 të Rregullores, Komitetet joobliguese mund të kuptojnë persona të cilët nuk janë anëtarë të Kuvendit.

Pavarësisht nga ajo që u tha, shumica e anëtarëve të Komiteteve joobliguese duhet të jenë gjithnjë anëtarë të Kuvendit të Komunës.

Përbërja e Komiteteve duhet të pasqyrojë proporcionin e partisimit të partive dhe koalicioneve politike të Kuvendit.

Anëtarësia e secilit Komitet përcaktohet nga Kuvendi i Komunës në pajtim me Rregulloren, duke përfshirë pa kufuzim dispozitat e Seksionit 49 të Rregullores dhe Kuvendi i Komunës do ta plotësojë çdo vend që mund të lirohet brenda vitit.

Rregullorja parasheh që Komitetet e Obligueshme t'i kenë përsipër disa kompetenca dhe aktivitete.

Kuvendi i Komunës mund t'i shtojë kompetencat dhe aktivitetet e këtyre Komiteteve të Obligueshme nëse ato nuk janë në kundërshtim me ato të parapara me Rregullore.

Kompetencat dhe aktivitetet e komiteteve të tjera do të jenë në përputhje me atë që iu cakton Kuvendi i Komunës kohë pas kohe. Kuvendi i Komunës do të bartë përgjegjësinë kryesore për çështjet e parapara me nenin 11.3 të Rregullores.

Në mbledhjen e tyre të parë të çdo viti fiskal, Kuvendi i Komunës dhe secili nga komitetet duhet të caktojë datat për takimet e tyre të rregullta që do të mbahen gjatë vitit. Datat mund të ndryshojnë varësisht nga ndonjë vendim tjetër. Mbledhjet plotësuese mund të thirren në çdo kohë.

Të gjitha mbledhjet do të mbahen në pajtim me Rregullat e Procedurës. Kryesuesi i mbledhjes do të sigurojë se të gjithë anëtarët që marrin pjesë në mbledhje kanë të drejta dhe mundësi të barabarta për të marrë pjesë në rrjedhat e mbledhjes.

## **Komiteti për Politikë dhe Financa**

### **Seksioni 1**

#### **Neni 58.**

Komiteti për Politikë dhe Financa emërohet nga Kuvendi. Anëtarët e tij janë anëtarë të Kuvendit, por mund të jenë edhe jo anëtarë të Kuvendit. Anëtarët e Kuvendit e përbëjnë shumicën e Komitetit.

Në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa mund të marrin pjesë edhe udhëheqësitë e Komiteteve tjera të Kuvendit.

Në pajtim me Seksionin 22.2 të Rregullores, Komitetin për Politikë dhe Financa e kryeson Kryetari i Komunës, i cili duhet të vendosë edhe për çështjet të cilat duhet të shqyrtohen në këtë Komitet.

Komiteti për Politikë dhe Financa ka përgjegjësinë:

1. për propozimin e projektbuxhetit,

2. për identifikimin dhe hartimin e programeve zhvillimore dhe strategjike të Komunës,
3. për përcaktimin e formave dhe mënyrave të organizimit për të hyrat në buxhetin fiskal, si dhe
4. bën politikën e investimeve dhe harxhimeve nga mjetet buxhetore.

## **Komiteti i Komuniteteve**

### **Seksioni 2.**

#### **Neni 59.**

Komiteti i Komuniteteve duhet të formohet dhe të mbahet nga Kuvendi i Komunës, për qëllimet e parapara në Rregullore, duke përfshirë pa kufizime, dispozitat e Seksionit 23 këtu dhe në përbërjen e tij përveç anëtarëve të Kuvendit, mund të përfshihen edhe përfaqësues të komuniteteve, të cilët nuk përfaqësohen në Kuvend, por janë banorë të Komunës. Emërimi i anëtarëve jo delegatë të Kuvendit në Komitetin e Komuniteteve do të bëhet nga Administratori i Komunës i UNMIK-ut në pajtim me Seksionin 49 të Rregullores.

Komiteti i Komuniteteve do të promovojë të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe do të shqyrtojë drejt çdo shkelje që bëhet në këtë drejtim. Ai do t'ia paraqesë çështjen Komitetit për Ndërmjetësim dhe do të japë rekomandimin e tij Kuvendit të Komunës.

#### **Neni 60.**

Kuvendi i Komunës gjatë themelimit të Komitetit të Komuniteteve dhe Komitetit për Ndërmjetësim duhet të sigurojë se është zbatuar procedura për emërimin e anëtarëve të këtyre komiteteve në përputhje me dispozitën 23 të Rregullores.

## **Neni 61.**

Komiteti për Komunitete ka për detyrë që në kuadër të Komunës të sigurojë se:

- a) asnjë person i cili merr detyra publike ose mban post publik nuk guxon të bëjë diskriminimin ndaj asnjë personi tjetër për shkak të përkatësisë etnike, gjuhës ose raportit shoqëror me komunitete,
- b) të gjithë qytetarët të gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtat civile, politike, ekonomike, shoqërore, kulturore dhe mundësi të barabartë për punësim në Shërbimet Komunale në të gjitha nivelet,
- c) Shërbimi Komunal Civil të pasqyrojë në proporcion të drejtë numrin e përfaqësuesve të kualifikuar të komuniteteve në të gjitha nivelet.

# **Komiteti për Ndërmjetësim**

## **Seksioni 3**

### **Neni 62**

Komiteti për Ndërmjetësim formohet për qëllimet e parapara në Rregullore, duke përfshirë, pa kufizime, dispozitat e Seksionit 23 këtu dhe përbëhet nga anëtarësia e Kuvendit të Komunës me numër të barabartë të: 1. anëtarëve të Kuvendit të cilët nuk i përkasin Komitetit të Komuniteteve dhe 2. anëtarëve përfaqësues të komuniteteve të Komunës të cilët nuk i përkasin komunitetit që është shumicë në Komunë.

Emërimi i anëtarëve në Komitetin për Ndërmjetësim do të bëhet nga Administratori Komunal i UNMIK-ut në pajtim me Seksionin 49 të Rregullores.

### **Neni 63**

Komiteti për Ndërmjetësim duhet t'i kryejë funksionet e parapara në Seksionin 23.7 të Rregullores, duke përfshirë detyrat në vijim:

Të shqyrtojë të gjitha çështjet të cilat ia parashtron Komiteti i Komuniteteve, të bëjë hetime të nevojshme (të grumbullojë informata) për të konstatuar se janë shkelur ose se a mund të shkilen të drejtat e një komuniteti, të vlerëson për rekomandim, që çështjen e ngritur dhe të shqyrtuar paraprakisht në Komitet t'ia paraqesë Kuvendit për shqyrtim.

#### **Neni 64.**

Komiteti për Ndërmjetësim do ta analizojë në hollësi çështjen e paraqitur nga Komiteti Komuniteteve dhe do të kërkojë zgjidhjen e saj përmes ndërmjetësimit. Çështjet që ky Komitet arrinë t'i zgjidhë përmes ndërmjetësimit nuk ka obligim që t'ia rekomandojë Kuvendit për shqyrtim.

## **Zyra e komunitetit**

### **Seksioni 4**

#### **Neni 65**

Në pajtim me Seksionin 23.11 të Rregullores, Zyra e Komunitetit do të formohet me qëllim të përmirësimit, mbrojtjes dhe të sigurimit të shërbimeve të barabarta publike në nivel komunal.

#### **Neni 66.**

Siç parashihet në Seksionin 23.13 të Rregullores, Zyra e Komunitetit është pjesë integrale e Komunës dhe e strukturës së përbashkët Administrative e cila financohet nga buxheti i Komunës.

Zyra e Komunitetit drejtohet nga një Drejtor, anëtar sipas detyrës zyrtare i Bordit të Drejtorëve, i cili për punën e tij dhe të zyrës i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv dhe Kuvendit të Komunës.

Siç parashihet në Seksionin 23.11 të Rregullores, Zyra e Komunitetit ka karakter të përkohshëm dhe duhet të vazhdojë derisa Autoriteti Qendror ose

trashëguesit e tyre e përcaktojnë se një zyrë e tillë më nuk është e nevojshme.

Personeli i Zyres së Komunitetit gëzon të njëjtin Status të personelit të Shërbimit Civil të Komunës.

Siç është paraparë në Seksionin 49.2. të Rregullores, Administratori i Komunës i UNMIK-ut mund të emërojë Kryesinë dhe personelin e Zyrës së Komunitetit dhe mund të themelojë nënzyra të Zyrës së Komunitetit.

Në lokalitetet e caktuara mund të themelohen edhe nënzyrat e Komunitetit për shërbimet e parapara në Seksionin 23.13 të Rregullores, duke përfshirë ofrimin e Shërbimeve Civile dhe Komunale sipas nevojës.

Vendimin për themelimin e nënzyreve e miraton Kuvendi i Komunës.

## **Bordi i Drejtorëve**

### **Pjesa 3**

#### **Neni 67**

Kuvendi i Komunës me propozim të Kryetarit të Komunës emëron një Bord të Drejtorëve.

Bordin e Drejtorëve e përbëjnë drejtorët e drejtorive të Komunës dhe Drejtori i Zyrës së Komunitetit.

Drejtorët duhet t'i përgjigjen Kryeshefit Ekzekutiv dhe Bordit të Drejtorëve lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, kurse Kryetari dhe komisionet përkatëse Kuvendit të Komunës.

Bordi i Drejtorëve, Kryeshefi Ekzekutiv e drejtorët e drejtorive, bien aktvendime dhe akte të tjera juridike nga kompetencat e tyre.

#### **Neni 68.**

Kuvendi i Komunës do të bëjë emërimin formal të çdo drejtori pas shqyrtimit të propozimit të arsyeshëm dhe të justifikueshëm nga Kryetari dhe Kryeshefi Ekzekutiv. Emërimi mund të bëhet për një periudhë të pacaktuar ose të caktuar që nuk lidhet me kushtet e punës së anëtarëve të

Kuvendit të Komunës. Derisa nuk është paraparë këtu, duke përfshirë dispozitat e Nenit 72, asnjë person i cili nuk ka kualifikimet e përshkruara me Statut ose që nuk ka qenë i përfshirë në procesin e rekrutimit të paraparë me Statut nuk do të ketë të drejtë për t'u emëruar përveç ata që janë paraparë në nenin 72 al. 2. Kryetari dhe Kryeshefi Ekzekutiv mund të marrin parasysh më tepër se një kandidat për çdo post zgjedhor nga ana e Kuvendit të Komunës.

Kryetari dhe Kryeshefi Ekzekutiv me ndihmën e Kolegjit do ta zbatojnë procesin e zgjedhjes për çdo pozitë. Kolegji do të emërohet nga Kuvendi i Komunës dhe do të kryesohet nga Kryetari. Në mesin e anëtarëve të vet, Kolegji mund të emërojë persona me kualifikime akademike ose profesionale ose me përvojë në fushat e aktiviteteve që bien nën përgjegjësinë e paraqitësit që nuk janë anëtarë të Kuvendit të Komunës.

Para emërimit, Kryetari, Kryeshefi Ekzekutiv dhe Kolegji do ta informojnë Kuvendin e Komunës se kandidatët i përmbushin kushtet e parapara sipas Statutit.

Rekrutimi për secilin vend pune duhet të bëhet në bazë të konkurrencës së hapur. Secili vend i lirë pune duhet të shpallet publikisht dhe kandidatëve do t'u lihet një afat prej së paku katërmëdhjetë ditësh brenda të cilit ata duhet të konkurrojnë, duke filluar prej ditës kur është shpallur konkursi.

Secili kandidat duhet t'i parashtojë këto dokumente:

- a) Formularin e plotësuar për konkurrim.
- b) Konfirmimin me shkrim të kandidatit se ai iu është përmbajtur kushteve nga Neni 72 (a).
- c) Detajet mbi kualifikimet profesionale dhe arsimore (faktet që i vërtetojnë kualifikimet do të kërkohen prej kandidatit të suksesshëm).
- d) Deklarata mbështetëse e kandidatit, që jep informata për qëllimet e Nenit 72 (d) – (e) dhe çfarëdo informata të tjera relevante.

Komisioni mund të përpilojë dhe të përdorë teste praktike për kandidatët dhe mund t'i përdorë procedurat e listës së ngushtë. Kriteri i listës së ngushtë ndërlihet vetëm me kualifikimet për emërim dhe do të përdoret rregullisht të të gjithë kandidatët.

Të gjithë kandidatët, ose të gjithë kandidatët e mbetur pas çfarëdo procedure të listës së ngushtë, siç mund të jetë, rasti do të intervistohen nga Kryetari, Kryeshefi Ekzekutiv dhe nga Komisioni. Komisioni pastaj do ta bëjë vlerësimin me shkrim të kandidatëve të intervistuar, i cili vlerësim duhet të jetë i drejtë dhe i barabartë për të gjithë të intervistuarit dhe të bëhet vetëm

në bazë të kriterëve profesionale. Vlerësimi duhet t'i paraqitet Kuvendit të Komunës para se ai të vendosë.

Seksioni 31.4. i Rregullores thekson se Drejtori mund të shkarkohet vetëm nga Kuvendi i Komunës dhe vetëm në bazë të asaj se ai ose ajo ka dështuar në zbatimin e detyrave të tij ose saj, ose vendi i tij i punës nuk është i nevojshëm më. Përveç në rastin e shkeljeve serioze që e arsyetojnë shkarkimin e menjëhershëm, ose kur vendi i tij i punës nuk është i nevojshëm më, Kuvendi i Komunës nuk do të marrë parasysh propozimin për shkarkim të drejtorit nëse nuk është përfillur procesi i përshkruar në këtë Seksion.

Kryeshefi Ekzekutiv duhet ta njoftojë me shkrim drejtorin po qe se konsiderohet se paraqitja dhe sjellja e tij nuk i përmbush standardet e pranueshme. Njoftimi duhet t'i paraqesë arsyet pse kjo është konsideruar rast për shqyrtim si dhe veprimet të cilat duhet ti ndërmarrë Drejtori për ta përmirësuar paraqitjen dhe sjelljet e tij ose saj. Njoftimi mund të përmbajë vërejtjen se në rast të vazhdimit të paraqitjes ose sjelljes së pakënaqshme mund të rezultojë në shkarkim.

Drejtori mund të kërkojë për çfarëdo veprimi të ndërmarrë nën Seksionet e mëparshme të këtij Neni, që të rishqyrtohet nga një komision i pavarur i emëruar nga Kuvendi i Komunës. Komisioni do t'i ketë së paku tre anëtarë.

Të gjithë anëtarët e komisionit duhet të kenë përgatitje relevante në administratën publike ose në procedurat e punësimit. Anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe Shërbimit Civil të Komunës nuk kanë të drejtë të emërohen në këtë komision. Drejtorit do t'i jepet mundësia që t'i drejtohet komisionit.

Si rrjedhojë e shqyrtimit të tij, komisioni do t'ia paraqesë rekomandimet me shkrim Kuvendit të Komunës. Kuvendi i Komunës do t'i zbatojë këto rekomandime të cilat duhet të shënohen në procesverbal, nëse nuk ka arsye për të vepruar ndryshe.

Drejtorit duhet t'i jepet mundësia t'i drejtohet Kuvendit të Komunës para se të merret çfarëdo vendimi sipas këtij Seksioni.

### **Neni 69.**

Çdo Drejtor udhëheq me një Drejtorin komunale dhe një Drejtor me Zyrën e Komunitetit.

# Seksioni I

## Neni 70

Për vitin fiskal 2001, Komuna do të ketë drejtoritë dhe departamentet vijuese të Komunës,

1. Drejtoria për Administratë të Përgjithshme dhe B. lokale,
2. Drejtoria për Ekonomi dhe Financa,
3. Drejtoria për Shëndetësi, Përkujdesje Sociale dhe Çështje Gjinore,
4. Drejtoria për Arsim, Shkencë, Kulturë, Rini dhe Sport,
5. Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm, Ndërtim, Rindërtim dhe Zhvillim,
6. Drejtoria për Inspekcione dhe Shërbime Publike,
7. Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural,
8. Drejtoria për Çështje Pronësoreshme-Juridike, Kadastër dhe Gjeodezi,
9. Drejtoria për Siguri dhe Mbrojtje të Ambientit, dhe
10. Drejtoria për Komunikacion dhe Lidhje.

Kuvendi i Komunës mund të formojë dhe ndryshojë drejtoritë dhe funksionet e tyre në pajtim me Rregullat e Procedurës sa herë që e sheh të arsyeshme.

Për vitin fiskal 2001, numri i personelit që duhet emëruar ose angazhuar në çdo departament, së bashku me titujt dhe gradat e tyre do të përcaktohet nga Kuvendi i Komunës me rekomandimin e Komisionit për Politikë dhe Financa.

Kuvendi i Komunës do të vendosë për numrin e departamenteve dhe drejtorëve komunalë, detyrat dhe përgjegjësitë e çdo drejtori dhe veprimtarinë e punës të çdo departamenti të Komunës në mbledhjen e parë në çdo vit vijues fiskal dhe, do të miratojë numrin e personelit që do të emërohet ose angazhohet në çdo departament së bashku me titujt e tyre dhe gradat.

Gjatë marrjes së ndonjë vendimi sipas këtij kapitulli, Kuvendi i Komunës do të udhëhiqet nga parimet e efikasitetit dhe ekonomisë dhe do të sigurojë që të bëhet një sigurim adekuat buxhetor për vendime të qëndrueshme.

Sipas këtij kapitulli, Komiteti për Politikë dhe Financa do t'i përcjellë çështjet të cilat i trajton gjatë çdo viti fiskal.

Me rekomandimin e Komiteti për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës do të bëjë ndryshime në çdo kohë gjatë vitit lidhur me çfarëdo çështje që është paraparë në seksionet e mëparshme të këtij Neni.

Asnjë vendim i marrë sipas këtij Seksioni nuk do të ndryshojë detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrës së Komunitetit ose Udhëheqësit të Zyrës së Komunitetit, i cili mbetet ashtu siç është parashtruar në Rregullore.

## **Seksioni 2**

### **Neni 71**

Në pajtim me Nenin 31.1. të Rregullores, Bordi i Drejtorëve do të përbëhet prej udhëheqësve të departamenteve komunale dhe udhëheqësi i Zyrës së Komunitetit.

Kryesuesi i Bordit do të jetë Kryeshefi Ekzekutiv.

Bordi i Drejtorëve do të vendosë dhe përcjell procedurat e rregullta të parashtruara në nenin 31. 2. të Rregullores, për të siguruar kryerjen e detyrave në mënyrë efikase dhe të menjëhershme. Procedurat do t'i dorëzohen Kryetarit dhe Komisionit për Politikë dhe Financa për konfirmim. Kryetari do të mbikëqyrë punën e përgjithshme të Bordit të Drejtorëve dhe mund t'i raportojë Komisionit për Politikë dhe Financa për çfarëdo çështje lidhur me punën e Bordit.

Drejtorët do të:

- a) ndihmojnë Kuvendin dhe Komitetet e tij në sigurimin e të gjitha informacioneve dhe raporteve për procesin e marrjes së vendimeve,
- b) ndihmojnë Kryetarin dhe Kryeshefin Ekzekutiv në mirëvajtjen e punëve të përditshme të cilat kanë të bëjnë me drejtorinë përkatëse,
- c) zbatojnë të gjitha aktet dhe vendimet e Komunës,
- d) përgatitin programin e punës dhe prezantojnë raportet periodike të punës për drejtorinë përkatëse,
- e) propozojnë personelin udhëheqës dhe personelin tjetër – kryes të detyrave të punës për drejtorinë e vet,
- f) kryejnë edhe punë të tjera me të cilat i ngarkojnë Kuvendi, Kryetari ose dispozitat e veçanta ligjore të Autoritetit Qendror.

- g) jenë përgjegjës për udhëheqjen dhe kontrollin e përditshëm të punës së departamenteve të tyre dhe stafin e shpërndarë që punon në to,
- h) përgatitin dhe prezantojnë planet periodike të zhvillimit në sferën e tyre të përgjegjësisë dhe përcjelljen e këtyre planeve,
- i) përgjigjen në mënyrë efektive për çfarëdo ankese lidhur me sferën e tyre të përgjegjësisë,
- j) marrin pjesë, kontribuojnë dhe implementojnë punën e Kuvendit të Komunës dhe komisioneve të tij dhe punën e Kryetarit, Kryeshefit Ekzekutiv dhe Bordit të Drejtorëve.
- k) sigurojnë informata dhe ndihmë administrative për të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës lidhur me sferat e tyre të përgjegjësisë që është e nevojshme për punën e tyre si delegatë.
- l) sigurojnë që të ofrohet një qasje e drejtë dhe e barabartë për ato shërbime publike që bien nën përgjegjësinë e tyre,
- m) sigurojnë krijimin e mundësive të barabarta dhe të drejta të punësimit përbrenda departamenteve që bien në përgjegjësinë e tyre,
- n) përmbushin të gjitha detyrat dhe urdhëresat që u caktohen në mënyrë adekuate.

Gjatë përmbushjes së përgjegjësisë të tyre, drejtorët do të mbikëqyrin të gjitha udhëzimet, strategjitë, instruksionet dhe urdhëresat që u lëshohen atyre në mënyrë adekuate dhe do t'i marrin parasysh të gjitha parimet përkatëse në tërësi.

Drejtorët mund t'i delegojnë përgjegjësitë në pajtim me planin e mënyrën e delegimit të miratuar nga Bordi i Drejtorëve dhe Komisioni për Politikë dhe Financa.

## **Neni 72.**

Për të pasur të drejtë për emërim, kandidati për pozitën e drejtorit duhet të:

- a) jetë i aftë për t'i përmbushur përgjegjësitë e vendit të punës me orar të plotë pa kufizime dhe pengesa ligjore,
- b) ketë kualifikim përkatës profesional ose akademik (e preferueshme),
- c) ketë përvojë të gjatë në sferat e aktiviteteve të departamentit\eve për të cilin është përgjegjës,
- d) ketë aftësi për të udhëhequr dhe drejtuar departamentin\et e tyre:
- e) ketë shkathhtësi dhe kualitete personale për të punuar në mënyrë të suksesshme në një shoqëri multietnike.

Për shkak të natyrës specifike dhe të përkohshme të pozitës, kandidatët për pozitën e udhëheqësit të Zyrës së Komunitetit lirohen nga kërkesa për të qenë në harmoni me Nenin 72 (b) dhe (c).

### **Neni 73**

Zyrtarët e lartë të Komunës: Kryeshefi Ekzekutiv, anëtarët e Bordit të Drejtorëve, Drejtori i Zyrës së Komunitetit, Shefi i sektorit, nuk mund të jenë anëtarë të Kuvendit të Komunës ku ata janë të punësuar.

### **Neni 74.**

Konfliktet e kompetencave ndërmjet zyrtarëve të lartë të Komunës të cilët janë emëruar nga Kuvendi, i zgjidh Kuvendi.

Zyrtarët e lartë mund të largohen nga posti me dorëheqje ose mund të shkarkohen nga Kuvendi , vetëm në rast se nuk i kryejnë si duhet obligimet, apo kur pushon nevoja për atë post.

## **Shërbimi Civil Komunal**

### **Pjesa 4**

### **Neni 75**

Në pajtim me Seksionin 34.2 të Rregullores, kushtet e punës të Shërbimit Civil Komunal do të jenë të atilla që të lejojnë rekrutimin e personelit me kualifikim të lartë në bazë të kualifikimit dhe përvojës. Kjo objektivë duhet të arrihet përveç masave të tjera, me dhënien e prioritetit kandidatëve me kualifikime dhe\ose përvojë të duhur dhe duke u ofruar mundësi trajnimi pas punësimit dhe perspektivë për karrierë.

Punësimi në Shërbimin Civil Komunal do të mbikëqyret dhe rregullohet nga Bordi i Drejtorëve për të siguruar që shërbimi reflekton proporcion të drejtë të përfaqësuesve të kualifikuar të komuniteteve në të gjitha nivelet në përputhje me Seksionin 34.5 të Rregullores.

Bordi i Drejtorëve duhet të përpiqet të sigurojë balansin në barazinë gjinore, në të gjitha fushat dhe nivelet e Shërbimit Civil Komunal.

Shërbimi Civil Komunal si tërësi duhet të punësojë proporcion të drejtë të personave me të meta.

Objekt i dispozitave të Rregullores, Statutit dhe Rregullores së punës dhe dispozitave tjera të ligjit, kushteve të punës të nëpunësve civilë komunalë duhet të jetë i njëjtë me Kuvendin e Komunës, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe pas konsultimeve të duhura me personelin dhe organizatat që përfaqësojnë personelin, do t'i përkufizojnë kohë pas kohe. Politika kadrovike duhet të jetë jodiskriminuese.

Komitetit për Politikë dhe Financa do të emërojë një nënkomision, detyrat, e të cilit do të jenë këshillimi dhe konsultimi në përgjithësi për çështjet e resurseve njerëzore që kanë të bëjnë me Shërbimin Civil Komunal dhe në veçanti, mbi çështjet në vijim:

- a) kategoritë dhe numrat për kategori: mbikëqyrja dhe përgjegjësitë:
- b) detyrat dhe obligimet:
- c) delegimi i detyrave dhe obligimeve:
- d) rekrutimi dhe përzgjedhja:
- e) kushtet e pranimit:
- f) fillimi i punës në zyrë, praktika dhe lista rezervë:
- g) procedurat disiplinore dhe shkarkimi:
- h) procedura ankimore:
- i) procedura e kundërshtimeve:
- j) trajnimi dhe provimet:
- k) rishqyrtimi i paraqitjes dhe procedura e vlerësimit:
- l) përparimi dhe suksesi në karrierë:
- m) dosjet dhe referencat e stafit:
- n) kohëzgjatja e punës dhe njoftimi mbi pushimin e marrëdhënies së punës:
- o) pagesat dhe shpërblimet e tjera:

p) pagesa për udhëtim dhe mëditjet

q) Pushimi:

r) Rregullat e Shërbimit Civil Komunal.

Me qëllim të organizimit të shërbimeve, të kryerjes së punëve dhe përmbushjes së nevojave të drejtpërdrejta të popullatës, në kuadër të Komunës organizohet Shërbimi Civil Komunal.

Shërbimi Civil Komunal përbëhet nga: Kryeshefi Ekzekutiv, Bordi i Drejtorëve dhe personeli administrativ.

Shërbimi Civil Komunal i kryen detyrat dhe obligimet në mënyrë korrekte dhe të paanshme, duke respektuar palën e tretë dhe duke vepruar në pajtim me ligjin.

Personeli i Shërbimit Civil angazhohet në punë përmes konkursit publik, ndërkaq zgjedhja bëhet në bazë të kualifikimit dhe përvojës në punë.

Të gjithë nëpunësit civilë komunalë i zbatojnë urdhërat e eprorëve të tyre, dhe i përfillin urdhërat e tyre, përveç në ato raste kur detyrat e tyre janë në kundërshtim me ligjin ose me të drejtat dhe liritë e njeriut.

Shërbimi Civil Komunal duhet të pasqyrojë në mënyrë proporcionale numrin e përfaqësuesve të kualifikuar të komuniteteve në të gjitha nivelet.

## **K a p i t u l l i V**

### **Të drejtat dhe detyrat e anëtarit të Kuvendit**

#### **P j e s a 1**

##### **Neni 76**

Në kuadër të të drejtave dhe detyrave të Kuvendit, secili anëtar ka të drejtë të marrë iniciativë dhe të bëjë propozime, Kryetarit të Kuvendit, Kryeshefit Ekzekutiv, komiteteve, drejtorëve të drejtorive, t'u bëjë pyetje dhe të kërkojë

informacione dhe sqarime, që nga organet e qeverisjes lokale dhe shërbime profesionale të kërkojë ndihmë profesionale dhe sqarime të duhura për ushtrimin e funksionit të anëtarit të Kuvendit.

### **Neni 77.**

Asnjë anëtar i Kuvendit të Komunës nuk duhet të thirret në përgjegjësi penale e as të arrestohet, të paraburgoset ose të dënohet për mendimin e shprehur në lidhje me punën në Komunë dhe votën në Kuvend. Pavarësisht nga ajo që u tha, asgjë nuk do të ndikojë në përjashtimin e dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut duke përfshirë pa kufizim, 2000\4 (mbi ndalimin e nxitjes së mosmarrëveshjes ose jotolerancës kombëtare, racore, fetare ose urrejtjes etnike).

Derisa dispozitat e Seksionit 20 të Rregullores nuk janë të aplikueshme, çdo anëtar i Kuvendit ka të drejtë në mbledhje të Kuvendit t'i parashtrojë pyetje Kryetarit të Komunës, Kryeshefit Ekzekutiv dhe anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, për çështjet nga fushëveprimi në Komunë.

### **Neni 78.**

Derisa dispozitat e Seksionit 20 të Rregullores nuk janë të aplikueshme, çdo anëtar i Kuvendit ka të drejtë të paraqesë interpelancën për shqyrtim të çështjeve të caktuara në lidhje me punën e Kryetarit dhe udhëheqësve të tjerë të Komunës, të emëruar nga Kuvendi.

Interpelanca i paraqitet me shkrim Kuvendit të Komunës, me pyetjet të cilat duhet të shqyrtohen dhe duhet të jenë të formuluar qartë dhe arsyeshëm.

### **Neni 79.**

Pyetjet dhe kërkesat e anëtarëve të Kuvendit bëhen parimisht në fund të mbledhjes në mënyrë gojore apo me shkrim. Përgjegjet jepen në mbledhjen e ardhshme nga Kryetari, Kryeshefi Ekzekutiv, Drejtori apo nga ekspertët për çështjen përkatëse.

Informatat që i takojnë kategorive të përmendura në nenin 7.3 (a) – (c) të Rregullores do të jepen vetëm në kushte sipas të cilave ndalohet përhapja e tyre e mëtejme. Arsyet për masat e këtilla do t'i bëhen me dije anëtarit dhe do të shënohen në dosje.

Pavarësisht nga ajo që u tha, pyetjet dhe kërkesat për informata të bëra në pajtim me këto dispozita, të cilat: (I) prishin raportet dhe (II) nuk janë në interes të përgjithshëm publik duhet të refuzohen.

### **Neni 80.**

Anëtarëve të Kuvendit u jepet libreza-karta e identifikimit të delegatit. Përmbajtja, forma dhe mënyra e mbajtjes së evidencës të librezës së anëtarëve duhet të përcaktohet nga Kuvendi, ndërsa për procedurën e lëshimit kujdeset Kryeshefi Ekzekutiv.

Karta e identifikimit duhet të mbesë pasuri e Komunës dhe në rast se ndonjë nga dispozitat e Seksionit 20 të Rregullores bëhen të aplikueshme, delegati duhet ta kthejë kartën e identifikimit të lëshuar në përputhje me atë që u tha më lart.

### **Neni 81.**

Anëtarët e Kuvendit për pjesëmarrje në seancat e Kuvendit dhe në mbledhjet e Komiteteve duhet të lirohen nga ndërmarrja ose institucioni, vendi tjetër i punës ku ata janë në marrëdhënie të rregullt pune.

Brenda kufijve të përshkruar në Seksionin 19 të Rregullores, anëtarët e Kuvendit, anëtarët e Komitetit (duke përfshirë Kryetarin e Komunës Zëvendëskryetarin dhe kryesuesin) kanë të drejtë në kompensim për punën dhe aktivitetin e tij si anëtar i Kuvendit. Kompensimi për anëtarët e Kuvendit caktohet me vendim të posaçëm nga Kuvendi, i cili ndahet nga buxheti komunal.

Çfarëdo kompensim i tillë duhet të jetë në pajtim me dispozitat e këtij Statuti dhe udhëzimet e dhëna nga Autoriteti Qendror.

### **Neni 82.**

Në mbledhjen e parë të çdo viti fiskal, Kuvendi i Komunës do të vendosë për mënyrën e kompensimit për anëtarët e Kuvendit të Komunës (duke përfshirë Kryetarin, Zëvendëskryetarin dhe kryesuesin). Praktika e kompensimit të tanishëm është dhënë në shtojcën 4 që duhet t'i nënshtrohet ndryshimeve në pajtim me dispozitat e Statutit.

# **K a p i t u l l i VI**

## **Administrimi financiar**

### **Pjesa 1**

#### **Neni 83.**

Buxheti i Komunës, siç parashihet në Seksionin 37 të Rregullores duhet të jetë i balancuar, transparent dhe i bazuar në kritere objektive.

Buxheti i Komunës duhet të përmbajë planin për aktivitetet ekonomike brenda vitit fiskal, burimet e të hyrave, shpenzimet kapitale dhe ato të përditshme të Komunës.

Procedurat buxhetore, Rregulloret financiare dhe Rregullat e Procedurës (tërësisht të referuara këtu si “Rregullat Buxhetore dhe Procedurat”) që janë të aplikueshme për Buxhetin Komunal dhe janë të detajuara në Rregullat e Procedurës (Shtojcat 1, 2, 3 dhe 4). Rregullat Buxhetore të paraqitura në Rregullat e Procedurës (Shtojcat 1,2,3 dhe 4) do të jenë të aplikueshme në vitin fiskal 2001.

#### **Neni 84.**

Për Buxhetin e Komunës të hyrat sigurohen nga:

- 1) Autoriteti Qendror,
- 2) Të hyrat vetanake të Komunës (në këtë kontest të hyrat vetanake të Komunës duhet të përjashtojnë fondet e siguruara ato nën (I) më lart,
- 3) Donatorët ndërkombëtarë,
- 4) Nga vetëkontributi i qytetarëve,
- 5) Si dhe burimet legjitime që janë të lejuara me ligjet e aplikueshme.

# **Të hyrat nga Autoriteti Qendror Fiskal**

## **Seksioni 1**

### **Neni 85.**

Në pjesën e mjeteve financiare ato formohen prej transferit nga Autoriteti Qendror Fiskal në Komunë sipas kritereve të parapara për ndarjen e mjeteve komunale.

Komuna është e obliguar që me kohë t'i drejtohet Autoritetit Qendror Fiskal, me kërkesë të arsyetuar për mjetet që duhet t'i ndahen.

Nëse nga Autoriteti Qendror Fiskal i ndahen Komunës mjete me destinim për një veprimtari të caktuar, ato mjete nuk duhet të harxhohen për qëllime të tjera.

Komuna duhet t'i raportojë Autoritetit Qendror Fiskal për mënyrën e harxhimit të mjeteve që i ndahen nga Autoriteti Qendror Fiskal.

# **Të hyrat vetanake të Komunës**

## **Seksioni 2**

### **Neni 86.**

Komuna mund të krijojë të hyra vetanake në përputhje me ligjet dhe udhëzimet e Pushtetit Qendror duke përfshirë metodat në vazhdim:

- 1) Licencat dhe Pagesat që i cakton Komuna,
- 2) Të ardhurat nga pasuria e Komunës,
- 3) Gjobat dhe përqindja e gjobave,
- 4) Të ardhurat nga shfrytëzimi i infrastrukturës komunale.

## **Të hyrat nga donatorët**

### **Seksioni 3**

#### **Neni 87**

Për ta ndihmuar zhvillimin e Komunës, donatorët ndërkombëtarë mund të derdhin mjetet në Buxhetin e Komunës.

Nëse donatorët derdhin mjete në Buxhetin e Komunës me destinim të caktuar, ato mjete nuk mund të përdoren për qëllime të tjera.

Donatorët kanë të drejtë të informohen për mënyrën e harxhimit të mjeteve që i kanë derdhur në Buxhetin e Komunës.

## **Të hyrat nga vetëkontributi**

### **Seksioni 4**

#### **Neni 88.**

Për t'i përmbushur më mirë apo përmirësuar nevojat e qytetarëve, Komuna mund të sigurojë mjete edhe përmes deklaramit të drejtëpërdrejtë të qytetarëve në pajtim me Ligjet e aplikueshme. Mjetet e siguruar në këtë mënyrë mund të shfrytëzohen vetëm për atë qëllim që janë deklaruar qytetarët. Mënyra e deklaramit dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me vetëkontributin, më afër definoen me ligj dhe me vendim për dhënien e vetëkontributit.

#### **Neni 89.**

Varësisht nga dispozitat e Rregullores duke përfshirë Seksionin 46.2 të saj, Komuna disponon në mënyrë të pavarur të hyrat që i takojnë.

Për mënyrën e përdorimit të mjeteve Kuvendi i Komunës duhet të vendosë në pajtim me ligjet e aplikueshme, rregullat, Rregulloret sipas propozimit të Komitetit për Politikë dhe Financa.

### **Neni 90.**

Buxheti i Komunës, në pajtim me Seksionin 41. të Rregullores, aprovohet për një vit fiskal dhe viti fiskal fillon më 1 janar.

Komiteti për Politikë dhe Financa në pajtim me dispozitat e Rregullores, Statutin dhe Rregullat e Procedurës duhet t'ia prezentojnë me kohë Kuvendit Komunal Projektin e buxhetit për miratim.

Me buxhetin e Komunës duhet të parashihen të hyrat dhe shpenzimet fiskale, mënyra e shpenzimit të tyre dhe veprimtaritë për çka destinohen.

### **Neni 91.**

Raporti vjetor për Buxhetin, siç parashihen në Seksionin 42. të Rregullores, në fund të çdo viti fiskal duhet të publikohet.

Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për të siguruar që raporti vjetor t'i paraqitet Kuvendit të Komunës në pajtim me dispozitat e aplikueshme të Rregullores.

Për të përmbushur këtë përgjegjësi, Komiteti për Politikë dhe Financa merr këto masa:

- 1) Në çdo buxhet të përgatitur në përputhje me Kaptinën 7 të Rregullores fut synimet e Komunës në lidhje me secilën veprimtari për të cilën është përgjegjës,
- 2) I rishikon synimet në mënyrë të vazhdueshme,
- 3) Krijon procesin për monitorimin e punës në lidhje me synimet,
- 4) Identifikon nevojat aktuale dhe të parashikuara si dhe mënyrat me të cilat ato përmbushen,

Deklaron se si është përmbajtja ndaj pikave 1, dhe 4. të nenit 2.3 të Rregullores.

Raportin vjetor e aprovon Kuvendi i Komunës në bazë të propozimit të Komitetit për Politikë dhe Financa më së largu deri më 30 maj të vitit vijues.

Raporti duhet të përmbajë:

- të hyrat dhe shpenzimet e planifikuara,

- realizimet, synimet e planifikuara me buxhet dhe shkallët e realizimit të tyre,
- mënyrën dhe lartësinë e financimit të aktivitetit të caktuar,
- gjendjen financiare në ndërmarrjet komunale, buxhetin e të cilave e miraton dhe kontrollon Kuvendi i Komunës, dhe
- të dhënat e tjera të parapara me Ligj dhe akte të tjera nga lëmi i financave.

### **Neni 92.**

Varësisht nga dispozitat që rregullojnë shërbimet publike, duke përfshirë udhëzimet administrative që lëshohen nga Departamenti i Shërbimeve Komunale dhe Departamenti i Shërbimeve Publike (UNMIK), Komuna miraton Buxhetin e ndërmarrjeve komunale që kryejnë shërbime publike.

Buxheti i propozuar nga ndërmarrjet komunale duhet të përfshijë lartësinë e tarifës së propozuar për shërbimet që i kryen ndërmarrja dhe të dhënat e tjera të parapara me ligj.

Propozimi i buxhetit duhet t'i dorëzohet Kuvendit për miratim më së largu deri më 1 dhjetor, para vitit të ardhshëm fiskal.

Komuna kontrollon dhe mbikëqyr afarizmin financiar të ndërmarrjeve publike komunale dhe të gjitha organizatave jofitimpruese, e të cilat marrin ndihmë financiare nga Komuna.

### **Neni 93.**

Autoriteti Qendror, siç parashihet në Seksionin 43. të Rregullores, cakton revizorë të pavarur financiarë me qëllim të kontrollimit të aktiviteteve financiare në Komunë.

Çdo revizor i tillë duhet të ketë të drejtë t'i shikojë të gjitha deklaratat financiare, librat, shkresat, dhe dokumentet e tjera dhe mund t'i kërkojë ndonjë informatë, të cilat atij ose asaj i duhen për kryerjen e kontrollit.

Varësisht nga dispozitat që rregullojnë shërbimet publike, duhet përfshirë udhëzimet administrative që lëshohen nga Departamenti i Shërbimeve Komunale ose Departamenti i Shërbimeve Publike (UNMIK) revizori e kontrollon gjithë afarizmin – veprimtarinë financiare të ndërmarrjeve komunale, në bashkëveprim me kontrolluesit komunalë.

Revizori inspekton tërë veprimtarinë financiare të të gjitha organizatave jofitimprurëse, të cilat marrin ndihmë financiare nga Komuna së bashku me kontrolluesit komunalë.

Çdokush mund të paraqesë deklarime të mbikëqyrësi, lidhur me veprimtarinë financiare dhe çështjet e tjera financiare të Komunës.

Revizori mund të vendosë që t'i hetojë ato deklarime.

Revizori i dorëzon Kuvendit raport me shkrim për çdo kontroll financiar, për të cilin Kuvendi i Komunës merr vendim për veprimet që duhet të ndërmerren lidhur me secilin rekomandim që përmban raportin. Kuvendi nuk mund ta refuzojë asnjë prej rekomandimeve pa arsye të mjaftueshme me arsyet duhet të shënohen në procesverbalin e mbledhjes përkatëse.

## **Kapitulli VII**

### **Konflikti i interesave**

#### **Neni 94.**

Siç parashihet në Seksionin 17, 32 dhe 34, të Rregullores, delegatët e Kuvendit, Komitetit, Bordit të Drejtorëve, Kryetari, Zv/Kryetari, Kryeshefi Ekzekutiv, përjashtohen nga procedurat lidhur me marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me cilëndo çështje në të cilën ai ose ajo, apo ndonjë anëtar i afërt i familjes së tij ose asaj, ka interes personal apo financiar.

Pa e kufizuar atë që u tha në përgjithësi, kur Kryeshefi Ekzekutiv ka konflikt interesi, Kryetari do të aranzhojë rolin e tij që ka të bëjë lidhur me çështjen e caktuar që ky rol të ushtrohet nga vet ai/ajo ose nga drejtori që vepron nën mbikëqyrjen e tij/saj. Kur një Drejtor ka konflikt interesi, Kryeshefi Ekzekutiv do të aranzhojë rolin e tij që ka të bëjë me çështje të caktuar të ushtrohet nga vetë ai/ajo ose ndonjë drejtor tjetër që vepron nën mbikëqyrjen e tij/saj.

Përjashtimi nga procedurat e marrjes së vendimeve të zyrtarëve të përmendur mund të bëhet me tërheqjen e tyre vullnetare ose me vendim të shumicës së atij kuorumi ose me kërkesë të pales së tretë nëse personat e

përmendur janë drejtëpërdrejtë të përfshirë në atë çështje e cila mund të shpjerë deri te konflikti i interesave.

#### **Neni 95.**

Siç parashihet në Seksionin 17,32 dhe 34 të Rregullores, çdo anëtar i Kuvendit dhe funksionar i lartë komunalë obligohet që të bëjë deklaratë paraprake me shënime të plota mbi interesat e tyre financiare në momentin e pranimit të funksionit, sikur edhe për çdo ndryshim eventual që ndodh gjatë mandatit. Për regjistrat në fjalë, kujdeset Kryeshefi Ekzekutiv, ndërsa për zyrtarët e lartë komunalë, Kryetari i Komunës.

## **Kapitulli VIII**

### **Akti formal, dokumentet zyrtare dhe informatat**

#### **Neni 96.**

“Akti formal” do të thotë vendim unilateral i marrë nga Komuna dhe ka pasoja ligjore për një ose më shumë persona apo organizata.

Përveç në raste urgjente, arsyetimi për të gjitha aktet formale, duhet t'i komunikohet me shkrim palës në kohën kur është kryer veprimi formal. Në raste urgjente, arsyet do të jepen gojarisht kur është e praktikueshme dhe të komunikohen me shkrim sa më shpejt që është e mundur. Parimet e proporcionalitetit dhe mirëbesimit duhet të qeverisin në mdërmarrjen e të gjitha akteve formale.

Pala duhet të informohet me shkrim për çdo të drejtë për ankesë dhe për procedurën e shqyrtimit që ekziston në lidhje me veprimet formale. Kjo informatë do të jepet kur akti formal është kryer ose në rast urgjent sa më shpejt që është e mundur.

Të gjitha kontratat, marrëveshjet dhe dokumentet e tjera zyrtare të Komunës duhet të nënshkruhen nga Kryetari dhe nga Kryeshefi Ekzekutiv ose nga personat e autorizuar që të veprojnë në emër të tyre.

Kryeshefi Ekzekutiv do ta vejë në dispozicion të publikut të gjithë materialin publik, ku përshkruhen detyrat dhe kompetencat e Komunës, organizimi i brendshëm dhe mënyra se si publiku mund të shfrytëzojë shërbimet që ofrohen.

Të gjitha letrat dhe kumtesat zyrtare që i lëshon Komuna do të kenë emrin, titullin, adresën dhe numrin e telefonit të punës të personit që i ka lëshuar dhe që mund të ofrojë informata me të hollësishme lidhur me çështjen në fjalë.

Dokumentet që janë për inspeksion sipas nenit 7. të Rregullores do të lëshohen pas pranimit të kërkesës, gjatë orarit të punës dhe në vendin ku ato mbahen. Personi që dëshiron ta kontrollojë një dokument duhet të tregojë të dhëna të mjaftueshme në mënyrë që të mundësohet identifikimi i dokumentit dhe varësisht nga kërkesa, atij do t'i tregohet vendi ku mund ta gjejë dokumentin.

Personi që inspekton dokumentin do të ketë mundësi ta bëjë një kopje të dokumentit për shfrytëzimin e vet. Komuna mund ta lëshojë një kopje dhe të kërkojë një tarifë që nuk tejkalon çmimin e kopjes.

Nëse një person dëshmon se dokumenti, të cilin e mban Komuna përmban informata të gabueshme, ai/ajo do të ketë të drejtë të kërkojë që ato informata të përmirësohen falas.

## **Kapitulli IX**

### **Dispozitat e veçanta**

#### **Neni 97.**

Ky Statut do të plotësohet dhe ndryshohet në pajtim me dispozitat e Rregullores dhe Statutit.

Asnjë nga dispozitat e Statutit nuk duhet të veprojë në drejtim të ndryshimit, plotësimit, modifikimit të ndonjë dispozite të Rregullores. Në rast se ekziston kolizioni, atëherë vlejnë dispozitat e Rregullores.

### **Neni 98.**

Varësisht nga pajtueshmëria me dispozitat për miratimin e Statutit nuk duhet të veprojë në drejtim të ndryshimit, plotësimit, modifikimit të ndonjë dispozite të Rregullores.

Nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Statuti pushojnë të vlejnë të gjitha dispozitat dhe aktet komunale të mëparshme në ato pjesë ku janë në kundërshtim me Rregulloren dhe këtë Statut.

Asgjë në këtë dispozitë nuk do të ndikojë në përjashtimin e dispozitave të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

### **Neni 99.**

Prej ditës së miratimit të këtij Statuti në afat sa më të shkurtër të bëhet harmonizimi i të gjitha akteve tjera të komunës dhe Rregulloreve të Komunës me këtë Statut. Ky Statut hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Kuvendi i Komunës.

Pavarësisht nga ajo që u tha, asgjë në këtë nen nuk do të ndikojë në cenimin e të drejtave ligjore dhe përgjegjësisive të personave fizikë dhe juridikë në mënyrë retroaktive.

### **Neni 100.**

Në rast dorëheqjeje të më shumë se 45% (dyzet e pesë për qind) të anëtarëve të Kuvendit në të njëjtën kohë, atëherë i tërë pushteti në pajtim me Rregulloren, do t'i kthehet përkohësisht Administratorit të Komunës deri në udhëzimin tjetër nga Autoriteti Qendror ose nga rezultati i zgjedhjeve komunale.

### **Neni 101.**

Interpretimi i këtij Statuti duhet të qeveriset nga fryma dhe synimi i Rregullores nr. 2000-45.

Në rast konflikti në interpretimin e këtij Statuti meritohet do të jetë teksti i këtij Statuti në gjuhën shqipe.

### **KUVENDI KOMUNAL PRIZREN**

**Asambleja Komunale**

**Nr. 01-011-76**

**Më 9 gusht 2001**

**P r i z r e n**

**Kryetari i Kuvendit**  
**Mr. Eqrem Kryeziu**

**Administratorja Komunale**  
**Sujata Saunik**